

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6352  
E enjte, 1 korrik 2021  
çmimi 0.40 €

## KQZ-ja emëron anëtarët e 38 komisioneve komunale të zgjedhjeve

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

QEVERIA E KOSOVËS TË MËRKURËN KA MBAJTUR MBLEDHJEN E RADHËS

FAQE 3

# KURTI THOTË SE KA PASUR PËRPARIM KËTO 100 DITË, OPOZITA E QUAN QEVERISJE TË DOBËT



Kryeministri Albin Kurti ka mbajtur të mërkurën mbledhjen e kabinetit qeveritar në të cilën ka numëruar të arriturat e 100 ditëve të qeverisjes së tij. Ai ka thënë se gjatë kësaj periudhe janë marrë 144 vendime dhe se prioritet i qeverisë së tij fillimisht ka qenë menaxhimi i pandemisë. Kurti ka theksuar se janë përbushur

premtimet bazë për menaxhimin e pandemisë. Ai ka thënë se Kosova ka arritur të sigurojë rreth dy milionë doza të vaksinës kundër Covidit, rreth 200 mijë deri më tani të administruara. Përveç situatës epidemiologjike, Kurti ka treguar se gjatë qeverisjes së tij ka përmirësuar aspektin ekonomik

## AKTUALE



STANISHIQI DHE SIMATOVIQI DËNOHEN ME NGA 12 VJET BURGIM

F. 2

SHKARKOHET NGA DETYRA ZËVENDËSDREJTORESHA E AKI-së, VLORA HYSENI

F. 7

NËNTË RASTE TË REJA ME COVID NË KOSOVË

F. 3

LABORATORI "BIOHIT" LIRON 30 PËR QIND SHËRBYMET PËR ISH-LUFTËTARËT E UÇK-së NË DUKAGJIN

F. 6

## EKONOMI



BRENDA TRE MUAJVE RRIKET PËR 2.4 PËR QIND PAPUNËSIA NË KOSOVË

F. 8

SHTYHET AFATI PËR RIAPLIKIM PËR PËRFITUESIT E SKEMAVE PENSIONALE


F. 8

## SPORT



HITZFELD: XHAKA ISHTE KAPITEN I MADH KUNDËR FRANCËS

F. 15



ARRESTOHEN 21 PERSONA NË AKSIONIN E DYTË PËR RASTIN "SUBVENCIONET"

FAQE 5



ANALISTËT: OPOZITA S'DUHET TA IMITOJË LV-NË NË RAPORT ME DIALOGUN E BRUKSELIT

FAQE 3

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Stanishiqi dhe Simatoviqi dënohen me nga 12 vjet burgim

HAGË, 30 QERSHOR - Gjykata e Kombeve të Bashkuara në Hagë dënoi me nga 12 vjet burgim dy ish-shefa të shërbimit të sigurimit shtetëror të Serbisë, të akuzuar për udhëheqjen e grupeve paraushtarake gjatë luftërave në ish-Jugosllavi në vitet 1990. Të dënuarit janë Jovica Stanishiq, 70 vjeç, ish-shef i Shërbimit të Sigurimit Shtetëror të Serbisë, dhe zëvendësi i tij, Franko Simatoviqi, 71 vjeç.

Prokuroria kishte kërkuar dënim të përjetshëm, ndërsa mbrojtja,

lirim e tyre.

Grupet paraushtarake, të udhëhequra nga ta, kanë përfshirë njësitë elitare, të quajtura Beretat e Kuqe dhe Tigrat e Arkanit.

Të dyja njësitë dyshohet se kanë vrarë qindra njerëz.

Gjykata në Hagë ka liruar Stanishiqin dhe Simatoviqin nga akuzat për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit në vitin 2013. Por, pas protestave dhe apelit të prokurorëve, gjykatësit kanë urdhëruar në vitin 2015 rigjykim të rastit kundër tyre.

Rigjykimi ka nisur në vitin 2017.

Të dy të pandehurit janë deklaruar të pafajshëm për krime kundër njerëzimit, të tilla si: përndjekjet, vrasjet, dëbimet dhe transferimet me forcë.

Të dy kanë qenë bashkëpunëtorë të ngushtë të ish-presidentit serb Slobodan Millosheviq, i cili ka luftuar luftëra në Slloveni, Kroaci, Bosnje e Hercegovinë dhe Kosovë. Millosheviqi është gjykuar po ashtu në Hagë, por ka vdekur përpara se t'i shqiptohej dënimi në vitin 2006.



## BE-ja pajtohet për zgjatjen e sanksioneve ndaj Rusisë



BRUKSEL, 30 QERSHOR - Të mërkurën ambasadorët e Bashkimit Evropian ranë dakord të zgjasin edhe për gjashtë muaj sanksionet e gjera ekonomike të vendosura ndaj Rusisë për shkak të aneksimit të Krimesë dhe nxitjen e konfliktit në Ukrainë, thanë diplomatët.

Sanksionet ishin vendosur në vitin 2014.

Vendimi përfundimtar do të merret nga ministrat e Jashtëm të vendeve anëtare të BE-së gjatë një takimi më 12 korrik.

Sanksionet shënjestrojnë sektorët kryesorë të vendit,

përfshirë atë bankar, të energjisë dhe mbrojtjes.

Masat do të mbesin në fuqi pasi një plan i paqes për Ukrainën lindore për të cilin janë dakorduar Moskë, Kievi, Berlina dhe Parisi më 2015, nuk ka shënuar ndonjë përparim në zbatim.

Rusia ka aneksuar paligjshëm Gadishullin e Krimesë dhe ka mbështetur separatistët në lindje të Ukrainës, duke nxitur dhunë, e cila ka lënë mbi 13 000 persona të vdekur.

Tensionet u rritën në fillim të këtij viti pasi Kremli vendosi dhjetëra mijëra trupa në

kufirin me Ukrainën.

Javën e kaluar udhëheqësit e BE-së kundërshtuan një thirrje nga Gjermania dhe Franca për të rifilluar takimet me presidentin Vladimir Putin, të pezulluara që nga viti 2014. Ata thanë se ky do të ishte një lloj shpërblimi për Kremlinin.

Liderët e BE-së urdhëruan shefin e politikës së jashtme, Josep Borrell dhe Komisionin Evropian "të paraqesin planet për masa shtesë, duke përfshirë sanksionet ekonomike" kundër Rusisë nëse marrëdhëniet përkeqësohen më shumë.

## Italia përfundon tërheqjen ushtarake nga Afganistani



ROMË, 30 QERSHOR - Qeveria e Italisë ka njoftuar se ka përfunduar tërheqjen e trupave të saj nga Afganistani, duke i dhënë fund pranisë së saj 20-vjeçare në këtë vend.

"Natën e kaluar, misioni i Italisë në Afganistan ka përfunduar zyrtarisht", tha të mërkurën ministri italian i Mbrojtjes, Lorenzo Guerini. "Megjithatë, angazhimi i bashkësisë ndërkombëtare për

Afganistanin - duke filluar me Italinë - nuk mbaron këtu. Ai do të vazhdojë në forma të tjera", shtoi Guerini.

Italia ka pasur rreth 50 000 trupa në Afganistan gjatë 20 vjetëve të fundit. Prej këtyre, 53 janë vrarë dhe 723 janë plagosur.

Disa orë para Italisë, edhe Gjermania ka njoftuar se i ka dhënë fund pranisë ushtarake në Afganistan.

Ushtarët "tani janë duke u kthyer në shtëpi", ka thënë ministrja gjermane e Mbrojtjes, Annegret Kramp-Karrenbauer.

Të gjitha trupat e huaja pritet të tërhiqen nga Afganistani deri më 11 shtator.

Në këtë datë shënohet 20-vjetori i sulmeve terroriste të Al Kaidës në ShBA - ngjarje kjo që ka çuar në ndërhyrjen në Afganistan.

## Kim pranon se në Korenë e Veriut ka "krizë të madhe"

PENIANI, 30 QERSHOR - Udhëheqësi i Koresë së Veriut, Kim Jong Un, tha se dështimi për t'i zbatuar masat kundër koronavirusit ka shkaktuar "krizë të madhe". Agjencia shtetërore e lajmeve

KCNA tha se Kim i ka ndëshkuar disa zyrtarë të partisë në pushtet për "rrezikimin e sigurisë së vendit dhe të njerëzve". Raporti i KCNA-së nuk dha hollësi për natyrën e krizës. KCNA, po ashtu, nuk

specifikoi nëse shkarkimi i disa zyrtarëve të partisë ka të bëjë me neglizhencën ndaj detyrave që lidhen me pandeminë.

Koreja e Veriut nuk ka konfirmuar zyrtarisht asnjë rast me koronavirus - gjë që

është vënë në dyshim nga ekspertët ndërkombëtarë të shëndetësisë.

Por, vendi komunist ka ndërmarrë masa të rrepta kundër koronavirusit, duke mbyllur kufijtë dhe ndaluar udhëtimet e brendshme.



Për pasojë ka rënë edhe tregtia me Kinën. Koreja e Veriut varet nga Kina për ushqime dhe karburante.

ANALISTËT POLITIKË KANË KOMENTUAR SJELLJEN E OPOZITËS NË RAPORT ME DIALOGUN ME SERBINË

# Analistët: Opozita s'duhet ta imitojë LV-në në raport me dialogun e Brukselit

Njohësit e rrethanave politike në vend kanë vlerësuar se subjektet politike opozitare në raport me dialogun me Serbinë po sillen sikur Lëvizja Vetëvendosje (LV) dikur. Ata kanë thënë për gazetën "Epoka e re" se opozita duhet të jetë konstruktive në këtë proces dhe nuk duhet ta imitojë opozitarizimin e LV-së në raport me dialogun e Brukselit. Sipas tyre, në procesin e dialogut me Serbinë Kosovës i duhet konsensus nacional

**EPOKA E RE**

Muhamet KOCI

**PRISHTINË, 30 QERSHOR** - Njohësit e rrethanave politike në vend kanë kritikuar qasjen e opozitës ndaj dialogut me Serbinë. Ata kanë thënë për gazetën "Epoka e re" se subjektet politike opozitare po e kopjojnë diskursin e Lëvizjes Vetëvendosje (LV) sa ishte në opozitë për këtë çështje. Sipas tyre, PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja nuk duhet ta kopjojnë opozitarizimin e dikurshëm të LV-së.

Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka thënë për gazetën "Epokën e re" se subjektet opozitare nuk duhet ta imitojnë Lëvizjen Vetëvendosje duke kundërshtuar politikën transformuese të kryeministrit Albin Kurti në procesin e dialogut me Serbinë. "Opozita e ka gabim, nuk duhet ta imitojë Vetëvendosjen duke kundërshtuar politikën transformuese të kryeministrit Kurti. Fakti se Kurti tani po pranon dialogun, afirmon aspektet pozitive të dialogut në të kaluarën që e kanë mundësuar rumbullakimin e tërësisë territoriale të Kosovës, pasi që Marrëveshja e Brukselit mundësoi vendosjen e pikave doganore të Kosovës në veri, nxiti integrimin e serbëve në institucionet e Kosovës, pjesëmarrjen e tyre në zgjedhjet e Kosovës etj", ka thënë Maliqi.

Ai ka bërë me dije se pasi që Kosovës t'i hapet rruga e integritit në BE, do të kemi një fazë më të avancuar të integritit të serbëve në veri të vendit. "Kuptohet se këto procese u manipuluan nga

Beogradi duke krijuar Listën Serbe që i shërben Beogradit për t'i kontrolluar proceset politike në Kosovë, por kur një herë e pa kthim fuqizohet shtetësia e Kosovës, dhe kur Kosovës i hapen rrugët për integritet të papengura në BE dhe NATO, do të kemi një fazë më të avancuar të integritit të serbëve në veri të Kosovës. Nëse ka dyshime në zhvillimet pozitive në këtë drejtim, si edhe më herët, nuk do të duhej të ishin shqiptarët ata që pengojnë këto procese, por t'i lëmë Beogradit ta demonstrojë fytyrën e vërtetë të politikave të tyre retrograde", është shprehur Maliqi.

Edhe kryetari i Lëvizjes për Bashkim, Valon Murati, ka vlerësuar se opozita në raport me dialogun me Serbinë po përpiket të sillt si LV-ja dikur. "Ka kohë që bisedimet me Serbinë janë bërë pjesë e betejës elektorale ndërmjet partive politike shqiptare. Sigurisht që LV-ja këtë betejë politike e ka vendosur në skajet e saj duke e bërë të pamundur çdo debat normal rreth bisedimeve, madje duke i pamundësuar edhe kritikën konstruktive ndaj këtij procesi. Duke qenë se edhe partitë e establishmentit të vjetër, dialogun me Serbinë asnjëherë nuk e kanë trajtuar seriozisht, ato po përpiqen të sillen pak a shumë së paku në diskurs njëjtë sikur LV-ja dikur", ka thënë Murati për gazetën "Epoka e re".

Ai ka bërë me dije se rruga e duhur është arritja e një konsensusi nacional për këtë çështje. "Rruga e duhur, sipas mendimit tim, është arritja e një konsensusi rreth dialogut



dhe në këtë drejtim është kreu dhe parëndësishme pjesëmarrja ose jo e opozitës në bisedime. Sidoqoftë, me këto opsione që favorizojnë subjektet tona politike për momentin dhe me qasjen e tyre e shoh të pamundur arritjen e konsensusit. Asnjëra realitet nuk është e interesuar t'i zgjidhë problemet me Serbinë përmes bisedimeve. Shumica prej tyre mbijetojnë në skenën politike me temën e Serbisë dhe rrezikut nga ajo", ka thënë ai.

Kurse ish-ministria për Dialog, Edita Tahiri, ka thënë se opozita duhet të bashkëpunojë me qeverinë për këtë proces të rëndësishëm për vendin. "Është për keqardhje që nuk ka një konsensus më të

gjerë dhe një bashkëpunim më të mirë mes qeverisë dhe opozitës në këtë proces, sepse kjo është faza përfundimtare e dialogut ku duhet të ketë një pjesëmarrje edhe të opozitës në delegacionin për bisedimet e Brukselit. Shpresoj që në të ardhmen ta kemi një bashkëpunim të tillë. Kërkohej përfshirja e Kuvendit në bisedime", ka thënë për gazetën "Epoka e re" Tahiri. Edhe përfaqësuesit e Institutit Demokratik të Kosovës kanë bërë thirrje për konsensus nacional mes pozitës dhe opozitës për këtë temë.

Jeta Krasniqi nga KDI-ja ka thënë se Kuvendi duhet të përfshihet në këtë proces. "KDI-ja ka asistuar Kuvendin e Kosovës që të jetë sa më i

përfshirë në këtë proces. Ka pasur ngritje dhe ulje ky dialog, ku janë evidentuar disa çaste të veçanta. Gjatë vitit 2020 pamë rënie të dy qeverive dhe ardhjen në pushtet të Lëvizjes Vetëvendosje, kurse më 2021 po thuhet se po bëhet një rifillim. Qeveria Kurti ka thënë se dialogu nuk është një nga çështjet prioritare, por pamë se kërkesat që vinin nga jashtë e bën që dashur pa dashur të diskutohet kjo çështje", ka thënë Krasniqi.

Përfaqësuesit e opozitës e kanë kritikuar takimin e parë të kryeministrit Albin Kurti me presidentin serb Aleksandër Vuçiq në Bruksel. Ata kanë vlerësuar se ky proces po karakterizohet me mungesë të transparencës.

## Nëntë raste të reja me Covid në Kosovë



Prishtinë, 30 qershor (ER) - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike në Kosovë ka njoftuar të mërkurën se në 24 orët e fundit janë regjistruar edhe nëntë raste të reja me Covid-19, bazuar në testimin e 1 648 mostrave.

Të shëruar nga Covid-19 janë

edhe tetë pacientë, ndërsa raste aktive aktualisht janë 167. Prej 13 marsit 2020, kur janë regjistruar rastet e para të infektimit, autoritetet shëndetësore në Kosovë kanë regjistruar 107 758 pacientë me këtë virus.

Prej tyre 2 258 kanë vdekur,

ndërsa 105 333 janë shëruar. Deri të mërkurën, sipas Ministrisë së Shëndetësisë në Kosovë, janë dhënë 179 029 doza të vaksinës, ndërsa 41 573 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë kundër Covid-19. Procesi i vaksinimit në Kosovë ka nisur në fund të muajit mars.



QEVERIA E KOSOVËS TË MËRKURËN KA MBAJTUR MBLEDHJEN E RADHËS

# Kurti thotë se ka pasur përparim këto 100 ditë, opozita e quan qeverisje të dobët

Kryeministri Albin Kurti ka mbajtur të mërkurën mbledhjen e kabinetit qeveritar në të cilën ka numëruar të arriturat e 100 ditëve të qeverisjes së tij. Ai ka thënë se gjatë kësaj periudhe janë marrë 144 vendime dhe se prioritetet e qeverisë së tij fillimisht ka qenë menaxhimi i pandemisë. Kurti ka theksuar se janë përmbushur premtimet bazë për menaxhimin e pandemisë. Ai ka thënë se Kosova ka arritur të sigurojë rreth dy milionë doza të vaksinës kundër Covidit, rreth 200 mijë deri më tani të administruara. Përveç situatës epidemiologjike, Kurti ka treguar se gjatë qeverisjes së tij ka përmirësim në aspektin ekonomik

kontratë të negociuar për sigurimin e tyre, ndërkaq sot kemi dy milionë vaksina të siguruara, afër 400 mijë sosh kanë arritur dhe kemi mbi 200 mijë doza të administruara. Gjendja me pandeminë është vënë nën kontroll dhe situata është përmirësuar dukshëm. Në muajin mars deri në qershor kemi ulje prej 99-përqindësh të rasteve të reja, 97 për qind ulje të rasteve aktive dhe 86 për qind ulje të rasteve të hospitalizuara. Ky është sukses të cilit duhet t'i gëzohemi të gjithë sepse sot ndihemi më të sigurt ta takojmë njëri-tjetrin, t'i shijojmë ecjet dhe ajrin e pastër, me më pak frikë e me më shumë besim në institucionet tona që të bëjnë punën e duhur", ka thënë Kurti, duke shtuar se pandemia në këto 100 ditë është menaxhuar me sukses. "Vaksinat janë siguruar dhe së bashku kemi përmbushur premtimin bazë ndaj qytetarëve", ka deklaruar Kurti.

Kryeministri Kurti ka thënë se

sot është evidente se ekonomia është hapur pothuajse në tërësi dhe qytetarëve i është kthyer një formë e normalitetit, duke lehtësuar kështu edhe peshën e rëndë që izolimi dhe distanca sociale kishin në shëndetin tonë mendor. "Por pandemia ende nuk ka mbaruar. Rreziku nga virusi mbetet i pranishëm dhe ne duhet të sillemi me përgjegjësi dhe kujdes, duke respektuar udhëzimet e institucioneve shëndetësore. Pas pandemisë janë dy tema të cilat i kam përsëritur shpesh e për të cilat qytetarët na kanë votuar masivisht që ne të punojmë. E ato janë drejtësi dhe punë. Në këto 100 ditë ekonomia jonë i është përgjigjur pozitivisht qeverisjes sonë të mirë dhe masave tona ndaj pandemisë", është shprehur Kurti.

Kryeministri ka thënë se për periudhën e njëjtë, në krahasim me vitin e kaluar, eksportet janë rritur për 66 për qind, aktiviteti ekonomik për 15 për qind, të

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 30 QERSHOR** - Kryeministri Albin Kurti ka thënë të mërkurën se është shënuar përparim në tre muajt e qeverisjes. Ai ka thënë se gjatë kësaj periudhe janë marrë 144 vendime dhe se prioritetet e qeverisë së tij fillimisht ka qenë menaxhimi i pandemisë. "Sot janë bërë 100 ditë të qeverisjes që doli si rezultat nga zgjedhjet plebishitare të 14 shkurtit dhe unë jam i lumtur që të ndaj me ju progresin që kemi shënuar në këta tre muajt, por edhe

rrugëtimin e rëndësishëm që kemi filluar së bashku. Në këto 100 ditë ne kemi marrë 144 vendime dhe kemi kaluar projektligje e dokumente të rëndësishme të cilat kanë hedhur bazat për reforma afatgjata dhe themelet për shtet të drejtë e zhvillimor. Kur e bëmë betimin në Kuvend më 22 mars ne thamë se prioritetet kryesor është menaxhimi i pandemisë në mënyrë që të shpëtojmë jetë njerëzish të cilat po i humbim si pasojë e keq-qeverisjes më shumë sesa nga pandemia. U zotuar se do të bëjmë dy gjëra me urgjencë:

së pari, do të sillnim një strategji të ndalim trendin në rritje të infektiveve të reja dhe ta kthenim mbrapshtë trendin e tmerrshëm të vdekjeve si pasojë e Covid-19 deri në eliminim e tij; dhe, së dyti, të sigurojmë vaksina sa më shpejt e sa më shumë", ka thënë Kurti në mbledhjen e qeverisë.

Ai ka theksuar se në ditën kur e pranuan detyrën kishin 781 raste me infektive të reja me Covid-19 dhe 17 vdekje, kurse sot, sipas tij, janë nëntë raste të reja dhe asnjë vdekje. "Nuk gjetëm asnjë vaksinë kur u rikthyem dhe, për më keq, asnjë





hyrat buxhetore për 30 për qind. "Në pesëmujorin e parë të këtij viti, Dogana e Kosovës për herë të parë që nga themelimi i saj ka raportuar mbi 500 milionë euro të hyra për buxhetin e Kosovës, ndërkaq Administrata Tatimore e Kosovës ka raportuar se janë inkasuar rreth 60 milionë euro më shumë sesa në vitin e kaluar. Bazuar në këtë, qeveria ka miratuar projektbuxhet për vitin 2021 prej 2.5 miliardë eurosh sipas të cilit projektohet rritje ekonomike për 7.9 për qind, për dallim nga 5.2 për qind siç parashihej në fillim të vitit, dhe në të cilin buxhetit do t'i shtohen 155 milionë euro më shumë nga çfarë planifikohej. Ky nivel parashihej të arrihej vetëm në vitin 2023", ka thënë kryeministri Kurti.

### Opozita: Qeveria Kurti, më e dobëta

Opozita e ka komentuar punën e qeverisë Kurti në tremujorin e parë të punës. Përfaqësuesit e partive opozitare kanë vlerësuar se gjatë kësaj periudhe qeveria ka treguar mungesë vizioni dhe gatishmëri për t'u përballur me

sfidat e shumta të qytetarëve të Kosovës. Ata kanë deklaruar për gazetën "Epoka e re" se qeveria Kurti është ekzekutivi më i dobët që ka pasur Kosova deri më tani.

Anëtari i kryesisë i PDK-së, Betim Gjoshi, ka deklaruar për gazetën "Epoka e re" se kjo qeveri asnjëherë nuk ka treguar interesim për zgjidhjet e problemeve të qytetarëve. "Qeveria në 100 ditët e para ka treguar se është qeveri me mungesë vizioni dhe energjie. Që nga dita e parë nuk ka qenë e interesuar për halle të qytetarëve, por më shumë ka qenë për punësimin e ndonjë nipi a dajë. Pra, kemi parë një tendencë që t'i kapë të gjithë pushtetet, përfshirë edhe institucionet e pavarura", është shprehur ai.

Gjoshi ka vlerësuar se qeveria duhet ta kthejë vëmendjen nga hallet e qytetarëve, ta ndihmojë rimëkëmbjen ekonomike dhe ta rrisë vaksinimin e qytetarëve. "Duke parë qeverisjen në këto 100 ditët, e cila karakterizohet me një qeverisje të dobët. Pra, një qeverisje edhe më e dobët sesa kanë menduar kritikët, pritjet tona janë të vogla. Ne kërkojmë nga qeveria që të kthejë sytë nga nevojat qytetare,

të ndihmojë ekonominë dhe qytetarët, ta rrisë vaksinimin dhe t'i normalizojë marrëdhëniet me partnerët strategjikë e ta ndalë rehatimin e militantëve dhe ndërhyrjen e presionin tek institucionet e pavarura", ka thënë Gjoshi.

Anëtari i kryesisë i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Valon Murtezaj, ka vlerësuar se puna e deritashme e qeverisë është pa objektiva të qarta, pa dinamikë dhe pa energji. Sipas tij, kjo qeveri nuk po e konkretizon në punë përkrahjen e madhe që e ka marrë në zgjedhjet e 14 shkurtit. "Një fuqi e tillë, me votat në Kuvendin e Kosovës, në rrethana normale qeverisëse, i mundëson qeverisjes të ecë shpejt, pa pengesa për ta realizuar planin qeverisës. Përkundër të gjitha këtyre rrethanave, ajo çfarë po mund të vërejmë është se puna e qeverisë deri tani është pa objektiva të qarta, pa dinamikë dhe pa energji. Do të duhej të ketë dinamikë të madhe në të gjitha fushat, gjë e cila nuk po ndodh dhe të cilën nuk po mund ta konstatojmë", ka deklaruar Murtezaj për gazetën "Epoka e re".

Kurse nënkryetari i Aleancës për

Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Pal Lekaj, ka vlerësuar se qeveria Kurti është qeveria më e dobët që ka pasur Kosova. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se kjo qeveri i ka sjellë Kosovës vetëm regres. "Qeveria Kurti këto 100 ditët të saj ka performancën më të dobët në 100-ditëshin e të gjitha qeverive të kaluara. Ajo ka ardhur me premtime të mëdha për ta përmirësuar jetën e qytetarëve, ndërsa veprimet e saj kanë sjellë regres të madh në mirëqenie. Kujtojmë këtu dy vendimet e qeverisë Kurti për uljen e pensioneve dhe subvencioneve për bujq dhe mos të flasim për politikën e jashtme dhe udhëheqësin e këtij dikasteri", ka thënë Lekaj, duke përmendur edhe bisedimet me Serbinë. "Po ashtu, dështimi më i madh është ai i dialogut ku kryeministri harron të gjitha premtimet e tij dhe papritmas përfundon në një tavolinë me Aleksandër Vuçiqin. Qeveria Kurti do të jetë qeveria që do t'i dëshpërojë më së shumti qytetarët e Kosovës, shtu këtu procesin e vonuar të vaksinimit dhe mosrespektimin e Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike që ka shtrirë ekonominë e Kosovës në nivelet më të ulëta të saj", është shprehur Lekaj.

## Arrestohen 21 persona në aksionin e dytë për rastin "Subvencionet"

PRISHTINË, 30 QERSHOR - Policia e Kosovës ka vënë në pranga 21 zyrtarë të mërkurën në vazhdimin e aksionit që ka të bëjë me subvencionet në fushën e bujqësisë. Aksioni që nisi në orët e hershme të mëngjesit përfundoi me arrestimin e 14 zyrtarëve të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë dhe shtatë zyrtarëve në disa komuna të Kosovës. Në një konferencë për media, prokurori i rastit, Rafet Halimi, ka thënë se aksioni është zhvilluar në pesë komuna të Kosovës, përkatësisht në Prishtinë, Podujevë, Pejë, Gjilan dhe Istog. Sipas prokurorit, të arrestuarit dyshohen për disa vepra penale dhe në shumicën prej tyre janë inspektorë. "Janë arrestuar 21 të pandehur për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprat penale:

marrje ryshfet, dhënie ryshfeti, ushtrim ndikimi, keqpërdorim i detyrës zyrtare, legalizim i përmbajtjes së rremë dhe mashtrim me subvencione", ka thënë ai.

Sipas Prokurorisë, operacioni i sotëm është vazhdim i aksionit të datës 24 shkurt dhe 25 shkurt gjatë të cilit ishin arrestuar 12 të pandehur.

Prokurori Halimi nuk është përgjigjur në pyetjen se kur priten të ngrihen aktakuzat ndaj të pandehurve të arrestuar në aksionin e parë duke thënë se aksioni do të vazhdojë ende. Megjithëse ka thënë se pritet ekspertizë financiare, sipas prokurorit, dëmi material në këtë çështje mund të llogaritet mbi 1 milion euro.

Përfaqësuesi i Policisë së Kosovës në konferencë për media i ka falënderuar qytetarët për informacionet e



ofruara që i kanë ndihmuar zhvillimit të aksionit dhe u kanë bërë thirrje personave të prekur nga skema e dyshuar e mashtrimeve që të raportojnë

rastet në polici. Arrestimet e datës 24 dhe 25 shkurt ishin bërë, po ashtu, nën dyshimet për keqpërdorim të subvencioneve, marrjes së

ryshfetit dhe keqpërdorim të detyrës zyrtare. Gjatë bastisjes në shtëpitë e personave të arrestuar ishin sekuestruar rreth 400 mijë euro.

## Osmani priti në takim kryetaren e Kushtetueses, diskutuan për bashkëpunimin ndërinstytucional

PRISHTINË, 30 QERSHOR (ER) - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të mërkurën në takim kryetaren e Gjykatës Kushtetuese, Gresa Caka-Nimani, të cilën e ka uruar

për detyrën e re, duke i ofruar bashkëpunim ndërinstytucional. Më tej, presidentja Osmani ka theksuar rolin e rëndësishëm të Gjykatës Kushtetuese në garantimin e

kushtetutshmërisë si organ përfundimtar i interpretimit të Kushtetutës. Ndërkaq kryetarja e Gjykatës Kushtetuese, Caka-Nimani, ka theksuar se synon që të punojë për adresimin e

sfidave me të cilat përballet gjykata. Sipas saj, bashkëpunimi me institucionin e presidentit është i domosdoshëm për mbrojtjen e funksionimit demokratik të institucioneve.



## Funksionalizohet zyra e gjendjes civile në Dumnicë të Poshtme

**PODUJEVË, 30 QERSHOR (ER)** - Pas përfundimit të punimeve në ndërtimin e objektit të ri, ka filluar punën zyra e gjendjes civile në fshatin Dumnicë të Poshtme. Kjo zyrë ndodhet në objektin e Ambulancës së Mjekësisë

Familjare në këtë fshat, ndërsa në të marrin shërbime banorët e fshatrave Dumnicë e Poshtme, Dumnicë e Epërme, Llaushë e Poshtme, Llaushë e Epërme dhe Përpellac. Zyra funksionon sipas orarit të administratës komunale.



## Laboratori "Biohit" liron 30 për qind shërbimet për ish-luftëtarët e UÇK-së në Dukagjin

**PEJË, 30 QERSHOR (ER)** - Ish-deputeti i Kuvendit të Kosovës, Gazmend Sylja, ka bërë me dije se prej sot e tutje luftëtarët e UÇK-së në Dukagjin do të jenë të liruar 30 për qind nga të

gjitha shërbimet që kryen laboratorit 'Biohit' në Istog, Pejë, Deçan dhe Gjakovë. "Prej sot e tutje luftëtarët e UÇK-së në Dukagjin do të jenë të liruar 30 për qind nga të gjitha

shërbimet që kryen laboratorit 'Biohit' në Istog, Pejë, Deçan dhe Gjakovë. Në emër të luftëtarëve të Dukagjinit, faleminderit Bujar Rexhaj!", ka shkruar Gazmend Sylja.

## Kuvendarët e Gjilanit miratojnë vendimin për rrënimin e objekteve të institucioneve publike

**GJILAN, 30 QERSHOR (ER)** - Kuvendi Komunal i Gjilanit, nën drejtimin e Shpresa Kurteshit-Eminit, në vazhdim të seancës së djeshme ka miratuar sot vendimin për plotësimin dhe ndryshimin e kushteve ndërtimore si dhe rrënimin e objekteve të institucioneve publike në zonat e planeve rregulluese urbane.

Opozita (PDK, LV, Nisma, Vatra), e cila dje e braktisi seancën shkaku i këtij vendimi, pas insistimit që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës, nuk mori pjesë as në vazhdimin e saj. Festa Shabani ka thënë se ndërtimi i administratës komunale është një projekt i shkëlqyeshëm dhe nuk ka asnjë arsye pse të mos përkrahët, meqë realisht e

lehtëson jetën e qytetarëve të Gjilanit, të cilët për një dokument duhet të bëjnë 3-4 kilometra rrugë nëpër qytet, duke u endur nëpër qendra të ndryshme, meqë administrata është e shpërndarë në disa objekte. "E di se edhe qytetarët janë të interesuar për të marrë shërbime në një administratë të vetme dhe për t'u zgjeruar sheshi, siç parashihet te pika 2 e këtij vendimi", ka thënë Festa Shabani.

Shabani ka theksuar se nuk pajtohet me pikën ku thuhet se rrënohet objekti i policisë dhe pjesa e burgut dhe si kusht për ta votuar, kërkoj që te vendimi të bëhet një riformulim në formë të shkruar, ku thuhet se ruhet dhe konservohet një pjesë e burgut, pjesa që ka të bëjë me dhomat e burgut, që



shpërfaq një histori nga e kaluara jonë. Edhe Arta Haziri (AAK) ka thënë se i mbështet projektet e mëdha që janë në interes të qytetarëve të Gjilanit, por pa e përfshirë rrënimin e tërësishëm të objektit të burgut, që shpërfaq gjurmë historike nga e kaluara e popullit shqiptar, i cili këtu ka

përjetuar tortura gjatë okupimit serb. Drejtori i Urbanizimit, Bekim Bajrami, ka pohuar se dekorohet me propozimet për ta riformuluar vendimin dhe ka sqaruar se projekti për ndërtimin e administratës së re, në të vërtetë e përfshin edhe konservimin e burgut.

Kryesuesja Shpresa Kurteshi-Emini konstatoi se ky vendim hidhet në votim me plotësimin, ku thuhet se ruhet ose konservohet një pjesë e rëndësishme e burgut të Gjilanit, i cili tregon histori nga e kaluara e popullit shqiptar, veçanërisht dhomat e burgut. Po ashtu, Kuvendi miratoi edhe memorandumun e mirëkuptimit në mes të komunave Gjilan, Kamenicë e Viti dhe Qendrës për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve në Gjilan, derisa kërkesën për zëvendësim në Komitetin për Bashkëpunim Ndërkufitar dhe Komitetin për Kulturë, Rini dhe Sport e shtyu për seancën tjetër, meqë përfaqësuesi i subjektit Vatra, nuk ishte i pranishëm në seancë për ta dhënë arsyetimin.

## Haskuka sheh nga afër punimet për hapjen e puseve për ujitjen e tokave bujqësore

**PRIZREN, 30 QERSHOR (ER)** - Kryetari i komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka dhe drejtori i Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Agron Limani, kanë parë nga afër punimet që janë realizuar në kuadër të projektit "Hapja e puseve për ujitjen e tokave bujqësore", nga i cili kanë përfituar 50 fermerë. Pas kërkesave të shumta që janë paraqitur nga fermerët gjatë vitit të kaluar, të cilët nuk kishin qasje në sistemin e ujitjes për tokat bujqësore, kryetari Haskuka dhe drejtori Limani njoftuan se këtë vit

kanë filluar realizimin e këtij projekti për hapjen e puseve. "Uji është faktor kryesor për rritjen e prodhimtarisë bujqësore, ndërkaq prodhimtaria është faktor kyç për rritjen e punësimit dhe zhvillimit ekonomik të vendit. Andaj, që nga fillimi i mandatit kemi realizuar projekte të shumta për mbështetjen e fermerëve tanë, ndërkaq gjatë vitit të ardhshëm do të kemi edhe një projekt të madh në këtë drejtim", ka thënë Haskuka, i cili ka falënderuar drejtorin Limani për realizimin e këtyre projekteve.



## Për dy muaj u kryen 324 mijë analiza në Klinikën e Biokimisë

PRISHTINË, 30 QERSHOR (ER) - Klinika e Biokimisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës ka shënuar shifra rekorde në ofrimin e shërbimeve

laboratorike për periudhën prill-maj 2021. Gjatë këtyre dy muajve janë kryer 324 mijë e 12 analiza laboratorike për 68 mijë e 897 pacientë.

Vitin e shkuar, në të njëjtën kohë, për shkak të situatës me pandeminë Covid-19, që kishte prekur një pjesë të konsiderueshme të

personelit shëndetësor dhe kishte vështirësuar punën tej mase, u realizuan 50 mijë e 201 analiza për 6 mijë e 722 pacientë.



## Shkarkohet nga detyra zëvendësdrejtore e AKI-së Vlora Hyseni



PRISHTINË, 30 QERSHOR (ER) - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani dhe kryeministri Albin Kurti, kanë shkarkuar nga detyra zëvendësdrejtore e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, Vlora Hyseni. Vendimi është marrë në mbështetje të nenit 6 (paragrafi 4) të Ligjit nr. 03/L-063 për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë (GZ, nr. 30, 15 qershor 2008). "Vendimi për shkarkim e obligon znj. Vlora Hyseni ta bëjë dorëzimin e të gjitha mjeteve dhe materialeve me të cilat ka qenë e ngarkuar. Gjithashtu, znj. Vlora Hyseni, sipas vendimit, obligohet që t'i ruajë të gjitha informacionet që ka marrë gjatë ushtrimit të

detyrës, pavarësisht sesi i është dhënë qasja në to apo si i ka pranuar ato, apo në çfarëdo forme tjetër ka arritur të ketë informacione të klasifikuara. Zbulimi ose mosruajtja e informacioneve të klasifikuara paraqet vepër penale të dënueshme sipas Kodit nr. 06/074 Penal të Republikës së Kosovës, Ligjit nr. 03/L-178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë dhe legjislacionin tjetër përkatës në fuqi që ka të bëjë me informacionin e klasifikuar. Vendimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga presidentja Osmani dhe kryeministri Kurti, 30 qershor 2021", ka njoftuar Qeveria e Kosovës.

## KQZ-ja emëron anëtarët e 38 komisioneve komunale të zgjedhjeve

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 30 QERSHOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka emëruar rreth 250 anëtarë të Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve (KKZ) në 38 komunat e Kosovës. Para emërimit të tyre, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ka dërguar emrat e propozuar në Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Fillimisht, Arianit Elshani nga PDK-ja ka thënë se tash e një kohë janë duke munguar dy anëtarët e komisionit nga kjo parti që, sipas tij, është duke ndikuar në kuadër të mbështetjes dhe punës më të mirë të KQZ-së.

Ai ka thënë se kjo është edhe mungesë e gjithëpërfshirjes brenda KQZ-së.

Ndërsa Burim Ahmetaj, kryeshfexekutiv i SKQZ-së, ka thënë se janë duke punuar për zgjedhjet lokale lidhur me planin operacional dhe takimet me

zyrtarët komunalë për t'i realizuar edhe vizitat nëpër komuna rreth procesit zgjedhor dhe punës tutje.

Në anën tjetër, Yll Buleshkaj nga Zyra e Certifikimit të Partive Politike në KQZ, ka thënë se kanë marrë kërkesë për koalicion të dy subjekteve politike, Partia Boshnjake me VAKAT.

Më tutje, Florian Dushi nga LDK-ja ka pyetur Yll Buleshkaj lidhur me verifikimin e kandidatëve që, sipas tij, është skandalozë mënyra e qasjes dhe verifikimit, madje situata ka eskaluar kur Dushi është nxehur nga përgjigja e Buleshkajt.

Kurse Sami Kurteshi nga Vetëvendosja ka thënë se janë 22 persona që janë hequr nga lista për anëtarë të KKZ-së. "Janë 22 persona apo vende të lira që janë hequr nga lista, dhe nuk jam i bindur që të gjithë kanë një bazë ligjore, por këto vende duhet të mbushen tani", ka thënë Kurteshi.



## Omani pranoi kredencialet nga ambasadori jorezident i Bangladeshit

PRISHTINË, 30 QERSHOR (ER) - Presidentja Vjosa Osmani ka pranuar të mërkurën kredencialet nga ambasadori jorezident i Bangladeshit, Mosharraf Hossain Bhuiyan. Duke i uruar suksese në misionin e ri, presidentja Osmani ka

theksuar që Republika e Kosovës i vlerëson lart aleatët dhe partnerët e saj dhe se Kosova është mirënjohëse për mbështetjen e vazhdueshme nga Bangladeshi. Palët diskutuan për mundësitë

për shtim të bashkëpunimit në mes të dy vendeve, me fokus të veçantë te thithja e investimeve dhe identifikimi i mundësive të reja për zgjerimin e bashkëpunimit të deritashëm. Presidentja Osmani ka thënë se shpreson që Bangladeshi do

të vazhdojë ta mbështesë Kosovën në drejtim të konsolidimit dhe fuqizimit të shtetësisë në rrafshin ndërkombëtar, në veçanti lidhur me anëtarësimin në organizata ndërkombëtare, me ç'rast ambasadori Bhuiyan konfirmoi se



Bangladeshi mbetet një përkrahës i përhershëm në këtë drejtim.

# Brenda tre muajve rritet për 2.4 për qind papunësia në Kosovë

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË 30 QERSHOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Anketën e Fuqisë Punëtore, ku thuhet se shkalla e papunësisë për tremujorin e katërt 2020 në Kosovë ka arritur në 27 për qind, krahasuar me tremujorin paraprak që ishte 24.6 për qind, pra që i bie se brenda tre muajve papunësia është rritur për 2.4 për qind. "Papunësia më e theksuar ishte te femrat me 33.5 për qind, krahasuar me meshkujt me 24.3 për qind", thuhet në anketë. Sipas ASK-së, fuqia joaktive është mjaft e lartë me 58.7 për qind, me fokus të veçantë te femrat me 76.2 për qind, krahasuar me meshkujt me 40.9 për qind. "Shkalla e punësimit për tremujorin e katërt është 30.2 për qind. Punësimi më i lartë është te

meshkujt me 44.8 për qind, ndërsa punësimi te femrat është 15.8 për qind. Femrat janë të punësuara, kryesisht në sektorët e arsimit, tregtisë dhe kujdesit shëndetësor, me 51.5 për qind të tyre, ndërsa meshkujt janë kryesisht të punësuar në sektorët e ndërtimitarisë, tregtisë dhe prodhimit me 43.8 për qind", është thënë në anketën e ASK-së.

Sipas ASK-së, sektorët ekonomikë që prijnë me punësim vazhdojnë të jenë tregtia me 15.3 për qind, prodhimi me 13 për qind, ndërtimtaria me 11.1 për qind dhe arsimit me 9.9 për qind. "Sa i përket të punësuarve me kontrata, del se 44.6 për qind e personave të punësuar kanë kontratë të përhershme në punën e tyre kryesore, ndërkohë që 55.4 për qind kanë kontratë të përkohshme", është thënë në anketën e ASK-së.



## Oda Amerikane përshëndet aprovimin e Projektligjit për Themelimin e Gjykatës Komerciale



PRISHTINË, 30 QERSHOR (ER) - "Fuqizimi i sundimit të ligjit në përgjithësi dhe i drejtësisë komerciale në veçanti, e në këtë aspekt edhe rritja e efikasitetit në zbatueshmërinë e kontratave, janë parakushte të rëndësishme për nxitjen e investimeve të brendshme dhe tërheqjen e investimeve të jashtme. Prandaj, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë e vlerëson pozitivisht aprovimin nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të Projektligjit për Themelimin e Gjykatës Komerciale", thuhet në komunikatën e kësaj ode. Oda Amerikane vlerëson se një vendim i tillë i Qeverisë së Kosovës do të ndikojë pashmangshëm në ngritjen e sigurisë juridike në të bërit biznes, duke përmirësuar klimën e investimeve,

rrjedhimisht edhe imazhin e Kosovës para investitorëve të huaj. "Duke qenë edhe përgjigje ndaj propozimit të Odës Amerikane që nga viti 2016, për themelimin e një gjykate të veçantë e cila do të trajtonte në mënyrë efikase dhe profesionale kontestet e natyrës komerciale, aprovimi i projektligjit në fjalë nga ana e qeverisë kontribuon edhe në avancimin e dialogut publiko-privat", thuhet në komunikatën e Odës Amerikane në Kosovë. Krejt në fund, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë i bën thirrje Ministrisë së Drejtësisë që të përmbyllë Rishikimin Funkcional të Sektorit të Sundimit të Ligjit, e në këtë aspekt edhe aprovimin e strategjisë së sundimit të ligjit të vendit.

## Shtyhet afati për riaplikim për përfituesit e skemave pensionale

PRISHTINË, 30 QERSHOR (ER) - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka marrë vendim që ta pezullojë deri më 30 gusht obligimin për riaplikim dhe reduktim të procedurave për njohjen e së drejtës për ndihmë sociale për familjet të cilat duke filluar nga muaji prill 2021 kanë afatin

për riaplikim. "Gjithashtu, lirohen nga paraqitja e rregullt për qëllime të evidentimit apo lajmërimit përfituesit e skemave pensionale dhe kategoritë e tjera të përfituesve që janë të obliguar të paraqiten në zyrat përkatëse. Ky vendim është i vlefshëm deri më 30 gusht 2021 dhe i njëjti

mund të rishikohet duke pasur parasysh rekomandimet dhe/ose vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, përfshirë Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës", thuhet në njoftimin e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.





# 'Nëse nuk mund të ushqesh 100 vetë, të paktën ushqe vetëm një'



Rrugëtimin si misionare, Nënë Tereza e ka nisur në kishën e Letnicës në Kosovë, në moshën 17-vjeçare. Dy vjet më vonë, ka udhëtuar drejt Indisë. Në vitin 1950, krijoi urdhrin e saj Misionaret e Bamirësisë, që edhe sot udhëheq shtëpi për fëmijë të braktisur, njerëz të varfër dhe të sëmurë.

"Njerëzit që nuk kanë asgjë, që nuk i do askush, që janë bërë barrë mbi shoqërinë, që kanë harruar çfarë është dashuria... për ne, ata janë njerëz të Zotit", - ka thënë Nënë Tereza.

"Nëse nuk mund të ushqesh 100

vetë, të paktën ushqe vetëm një", - është tjetër porosi e saj, për njerëzit.

Dhembshuria, sakrifica dhe përkushtimi ndaj njerëzve në nevojë i kanë sjellë Nënë Terezës Nobelin për Paqe, në vitin 1979. Ajo, po ashtu është nderuar nga shumë udhëheqës të botës. Ish-presidenti i Shteteve të Bashkuara, Ronald Reagan, i ka dhënë Medaljen Presidenciale të Lirisë, ndërsa Mbretëresha Elizabeth e Britanisë, Urdhrin e Meritës.

Humanistja e madhe me origjinë shqiptare, ka qenë armike e

betuar e ndëshkimit kapital dhe kundërshtare e fuqishme e abortit, duke e cilësuar si "minuesin e paqes".

**Kur Nënë Tereza takuar kryeministren e Indisë, Indira Gandhi, për të kundërshtuar një program sterilizimi, që do të frenonte rritjen e popullsisë indiane, ajo është shprehur e mahnitur: Të takosh Nënë Terezën, do të thotë të ndihesh krejtësisht e përlurur.**

Figura e saj e pashembullt është motiv frymëzimi për njerëzit në mbarë botën, me episodet nga më të ndryshmet. Po shkëpusim një fragment, nga libri me autor Leo Maasburg, "Nënë Tereza, histori magjepsëse":

## Historia e parë

Unë nuk do ta harroj kurrë, sesi dy të rinj para shumë kohësh erdhën në shtëpinë tonë dhe më dhanë një shumë të madhe parash. Unë i pyeta: 'Ku i keni marrë të gjitha këto para?'. Më thanë: 'Ne jemi martuar para dy ditësh. Para se të martohemi, kishim vendosur, që mos të blejmë rroba martesë. Ne nuk bëmë dasmë. Paratë e dasmës jua japim Juve.' Unë e di saktësisht, se ç'do të thotë në vendin tonë, në një familje hindu, të mos blesh rroba martesë dhe të mos bësh dasmë. Prandaj i pyeta përsëri: 'Po, përse? Përse vepruat kështu?' Ata thanë: 'Ne e duami njëri-tjetrin aq shumë, sa që gëzimin e dashurisë duam ta ndajmë me njerëzit, të cilëve ju u shërbeni.' Si e

përfjetojmë ne gëzimin e dashurisë? Si e përfjetojmë ne këtë? Tek japim, derisa dhemb.

## Historia e dytë

Para se të shkoja në Etiopi, në Kalkutë erdhën disa fëmijë të vegjël tek unë. Ata kishin dëgjuar, se do të shkoja atje. Kishin ardhur, sepse kishin dëgjuar nga motrat, që fëmijët në Etiopi vuanin shumë. Ata vinin dhe secili prej tyre jepte diçka, disa edhe ato pak para që kishin. Një djalosh i vogël, erdhi tek unë dhe më tha: 'Unë nuk kam asgjë, nuk kam para, thjesht nuk

kam asgjë. Por, kam këtë copë çokolatë. Ndaj, ti merre me vete dhe jepua fëmijëve në Etiopi!'

Ky djalosh i vogël dashuronte me shumë dashuri, sepse ai mbase, për herë të parë në jetën e vet, mbante një copë çokolatë në dorë dhe e dha atë. E dha plot gëzim, për ta ndarë me të tjerët, për ta zbutur sadopak dhimbjen e dikujt tjetri, në Etiopinë e largët. Ky është gëzimi i dashurisë: të japësh, derisa të dhemb. I dhembte Krishtit, që na donte ne, sepse ai vdiq në kryq, për të na mësuar ne sesi duhet të duhemi. Kjo është rruga, sesi duhet të duami edhe ne: deri në dhembje.





# Konica, Princ Vidit: Mbaji larg hajdutët dhe intrigantët

**Nga: Marenglen KASMI**

Periodha e qeverisjes së Vidit (Wilhelm zu Wied) në Shqipëri (7 mars – 3 shtator 1914) u mbizotërua nga kontradikta të mëdha të brendshme dhe të jashtme. Konfliktet e brendshme buronin nga heterogjeniteti fetar i popullsisë shqiptare, politikat personale të figurave politike dhe po ashtu edhe nga tentativa e instalimit në Shqipëri të një pushteti ksenokrat.

Rivalitetet dhe interesat e ndryshme të Fuqive të Mëdha gjatë Konferencës së Ambasadorëve, para së gjithash të Austro-Hungarisë dhe Italisë, e kishin kthyer Shqipërinë në një “kukull loje”.

Këtë gjë e dëshmon edhe përzgjedhja e një figure të panjohur gjermane në krye të shtetit të ri shqiptar, siç ishte Wilhelm zu Wied. Kushtet dhe situata në të cilën Fuqitë e Mëdha vendosën të krijojnë Shqipërinë ishin shumë më të pafavorshme sesa në vendet e tjera të Ballkanit. Zhvillimi i vonuar social-ekonomik i

vendit, niveli i lartë i analfabetizimit, heterogjeniteti fetar, një elitë shqiptare e brumosur me mentalitet turk, mungesa e infrastrukturës dhe prapambetja e shoqërisë shqiptare, si edhe konfliktet e armatosura me vendet fqinjë e vështirësonin ngritjen e shtetit shqiptar.

Kandidaturat e paraqitura nga Austria dhe Italia për fronin shqiptar ishin të shumta. Edhe patriotët shqiptarë ishin fillimisht të ndarë mes tyre se cili duhej të ishte mbreti i tyre i ardhshëm.

Një nga mbështetësit e Wiedit ishte edhe Faik Konica. Sipas tij, Wiedi krijonte një përshtypje korrekte, por ajo që për atë dhe shumë të tjerë nuk kuptohej ishte ngadalësia që ai vepronte gjatë përgatitjes për të ardhur në Shqipëri. Ndër të tjera Konica shprehej në një intervistë të dhënë në gazetën “Freie Presse” më 27 janar 1914 se: “[...] Popullit shqiptar i pëlqen Princ Wiedi, si pasojë e cilësive të tij si ushtarak. Le të shpresojmë që, këto cilësi, nuk do të mposhten nga pasiguria dhe hezitimet e një diplomati”.

Konica shkoi në Potsdam [Berlin] në fundvitin 1913 për t’u takuar me Wiedin dhe për ta këshilluar personalisht atë për detyrën e vështirë që ai kishte marrë përsipër. Çfarë e këshillonte ai Wiedin dhe si e vlerësonte Konica Shqipërinë e viteve 1913, del qartë në Kujtesën që ai i dërgoi Wiedit më 9 dhjetor 1913 nga Potsdami, të cilën po e botojmë të plotë:

\*\*\*

“Kujtesë për Lartësinë e tij, Princin Wilhelm zu Wied, nga Faik Konica, Potsdam [Berlin], 9 dhjetor 1913

**Lartësia juaj, Princi  
Wilhelm zu Wied,**

që prej momentit që u përzgjedhët sovran i Shqipërisë nga gjashtë Fuqitë e Mëdha, të gjithë patriotët shqiptarë janë gati për t’ju shërbyer me besnikëri e për t’ju ndihmuar në realizimin e detyrës së lavdishme të konsolidimit dhe zhvillimit të kombit shqiptar. Së pari, është shumë e

nevojshme që, familja mbretërore, të bëhet e njohur në popull dhe sovranit t’i jepet një autoritet moral që nxit respektin dhe bindjen [përluljen] e popullit ndaj tij. Populli shqiptar, si një nga popujt më monarkikë të Ballkanit, ka tashmë besim të plotë te sovran i tij i ardhshëm dhe e pret ardhjen e tij si Udhëheqës i domosdoshëm e shpëtimtar, i cili do të dijë ta drejtojë atë [popullin] në rrugën e duhur.

nga Taboola  
Rekomanduar  
Mund t’ju interesojnë  
Ja si zhduka celulitin për vetëm 28 ditë <https://mjekesia.org/>  
Photos of Helen Mirren In Her Heyday  
TravelerMaster  
You May Be Able To Earn Money By Starting an Online ... Create eCommerce Store | Search Ads  
Por, sukcesi i kësaj dinastie të re do të varet nga realizimi i idealeve që populli ka krijuar për këtë Princ, gjë që mund të përmbledhet me disa fjalë.

Nëse gjatë regjimit turk triumfuan më të shkathtët e më të shpejtët, me regjimin e ri, populli shpreson se do të jetë

koha e njerëzve të ndershëm dhe të drejtë. Princi do të bënte mirë të vendoste sinqeritetin në themel të qeverisjes së tij. Pa diskutim, duhet të lihen mënjana e të largohen gjithë intrigantët që nuk janë të aftë t’i futen punës.

Këta njerëz, në vend që të përpiqen për zgjidhjen e problemeve të mëdha të kombit, preferojnë të fshihen në prapaskenat e oborrit mbretëror dhe në momentet e vështira, janë të parët që dezertojnë dhe rendin drejt padronëve të rinj. Favorizimi duhet të zhduket një herë e mirë nga Shqipëria.

Të njohësh njerëzit, ashtu si janë realisht dhe jo si mundohen ta shfaqin veten te miqtë apo armiqtë e tyre, përmbush gjysmën e asaj që anglezët e quajnë “King craft”, ose arti i të mbretëruarit. Dhe, gjysma tjetër e këtij arti përkon në zgjedhjen e burrave të zotë e të drejtë dhe që bota i njeh si të tillë.

Analfabetët, hajdutët, vrasësit dhe tradhtarët duhen mënjeluar nga shërbimi publik. Kjo vërejtje duket e

padobishme, por për fat të keq është e nevojshme. Në mesin e funksionarëve dhe xhandarëve të qeverisë provizore që vuan sot Shqipëria, pjesa e tyre më e madhe nuk di të shkruajë dhe të lexojë.

Pothuajse të gjithë janë hajdutë ose vrasës të njohur dhe madje, disa prej tyre, janë kundërshtarë të ashpër të mëmëdheut shqiptar. Mbajtja e tyre në pushtet, ndërkohë që në Shqipëri ka elementë të arsimuar, të ndershëm dhe patriotë të gatshëm për t'i shërbyer atdheut, do të çonte drejt një katastrofe të madhe. Një studim i detajuar mbi lëvizjen tonë kombëtare gjatë këtyre 18 viteve të fundit, duke përfshirë në të qoftë personat që kanë luajtur një rol të rëndësishëm për atdheun, qoftë spiunët e administratës turke, është më se i nevojshëm për të krijuar një ide të saktë mbi karakteret e shqiptarëve.

### Është e rëndësishme të mos harrojmë dy fakte:

– së pari, vetëm në sajë të nacionalistëve, të cilët arritën të zgjojnë ndërgjegjen kombëtare shqiptare dhe të krijojnë një lëvizje pavarësie duke e paguar këtë me mijëra sakrifica, u bë e mundur që Austria të mbrojtë përpara Evropës tezën e ekzistencës së një kombi shqiptar; – së dyti, zgjedhja e princ Wiedit u bë e mundur nëpërmjet veprimtarisë aktive të përditshme të nacionalistëve, në gazeta, takime si dhe në kongresin e njohur të Triestes të marsit 1913, të cilët mbrojtën dhe forcuan parimin se, princi i zgjedhur, duhej të ishte evropian dhe i krishterë. Pra, populli pret që të jenë nacionalistët ata që gëzojnë vlerësimin dhe besimin e sovranit dhe jo turqit e vjetër apo të rinj.

### Tre pika kryesore vihen re në programin e nacionalistëve:

1. Gjuha shqipe si e vetmja gjuhë zyrtare në administratën e vendit.
2. Qeverisja e vendit nga parlamenti.
3. Garantimi i lirisë absolute të shtypit.

### Çështja e parë nuk ka nevojë të mbrohet, kuptohet vetvetiu.

Ndërsa për çështjen e dytë, mund t'i trembemi faktit se, Austria dhe Italia, edhe pse nisur nga qëllime të mira, mund të japin këshilla të gabuara, të bazuara në frikën e remë se në Shqipëri nuk ekziston një opinion publik; dhe për rrjedhojë mund të krijohet një qeverisje despotike. Sigurisht, këto do të ishin këshilla të mjerueshme, por njëkohësisht dhe shumë të

rrezikshme. Absolutisht që Shqipëria ka nevojë për drejtësi dhe vendosmëri në qeverisje dhe jo për despotizëm.

Është e vërtetë që, gjatë viteve të para të qeverisjes, një senat, ose asamble këshillimore, i emëruar nga Princi, por i përzgjedhur me kujdes, mund të zëvendësojë dhe të krijojë kushtet për ngritjen e një regjimi parlamentar. Me të gjitha defektet e njohura që mbart, kjo është e vetmja mënyrë për të kanalizuar pakënaqësitë dhe për të ofruar një garanci serioze për dinastinë.

Në lidhje me çështjen e tretë, atë të lirisë së shtypit, është për t'u patur parasysh që, çdo përpjekje për ta kufizuar këtë liri do të çonte në krijimin dhe publikimin e gazetave opozitare në kryeqytetet e disa shteteve të vogla fqinje.

Kjo opozitë e organizuar tek armiqtë e Shqipërisë, do të ishte shumë herë më e rrezikshme, në krahasim me atë që do të krijohej brenda vendit, pasi kjo e fundit do të ishte më e lehtë për t'u mbajtur brenda kufijve normalë. Kuptohet që ajo [liria e shtypit] duhet të qeveriset nga një ligj serioz mbi shpifjet, siç ndodh edhe në Angli.

Nëse sovranit i merr në konsideratë këto pikëpamje, atëherë dinastia do të jetë e sigurtë dhe me një popullaritet të qëndrueshëm dhe jetëgjatë. Por, për momentin, ka disa probleme të ngutshme. Është shumë e rëndësishme që Princi të mos zbarkojë në Shqipëri pa qenë i ftuar më parë nga vendi dhe të mos vijë vetëm si një zgjedhje e Fuqive të Mëdha, pasi autoriteti i tij moral mund të vuante pasoja.

Ftesa e popullit shqiptar është e sigurt, por në kushtet aktuale ajo mund të marrë një formë tjetër, në trajtën e një delegacioni të përzierë, me përfaqësues të gjashtë rajoneve administrative autonome, të cilat janë edhe ndarjet e përkohshme [qeveritë lokale] në Shqipëri.

Thirrja e një asambleje kombëtare për të miratuar përzgjedhjen e Fuqive të Mëdha, do të ishte e rrezikshme për shkak të karakterit anti-katolik që fatkeqësisht, shtypi dhe agjentët italianë, misionarët protestante shqiptarë dhe vetë Esat Pasha, i kanë veshur kandidaturës së Princ Wiedit.

Pas pritjes që do i bëhet delegacionit gjithëpërfshirës, Princi duhet të udhëtojë për një periudhë të shkurtër në Krujë, kryeqytetin historik të Shqipërisë, për t'u prezantuar si princi mbretëruar, ose më saktë mbreti i vendit, pasi populli shqiptar parapëlqen këtë titull që e mbart prej një kohe të gjatë edhe mbreti i Malit të Zi.

Për sa i përket karakterit

# Historianët e Deçanit për betejën e Kosovës: Serbia po tenton ta falsifikojë historinë

Lidhja e Historianëve të Kosovës "Ali Hadri", dega në Deçan, ka akuzuar Serbinë se duke e prezantuar si fitore të saj betejën e humbur të Kosovës të vitit 1389, po tenton ta falsifikojë historinë duke u bazuar në mite dhe gënjeshtër. Në reagimin e tyre, historianët e Deçanit kujtojnë opinionin se historia nuk mund të shtrembërohet mbi Betejën e Kosovës.

"Beteja e Kosovës e 28 qershorit 1389, ka qenë disfata me e madhe që e ka pësuar aleanca ballkanike antiosmane e përbërë nga princat ballkanas, si dhe ndër fitoret më të mëdha që ka shënuar

Perandoria Osmane në shekullin XIV", thuhet në deklaratën e kryetarit të Lidhjes së Historianëve të Kosovës "Ali Hadri", Shkodran Imeraj.

Për më tepër, historianët e Deçanit thonë se humbja e aleancës ballkanike karshi forcave osmane, e cila festohet si fitore nga serbët, të cilët kanë qenë pakicë ushtarake në këtë aleance, nuk është asgjë tjetër se vetëm një mit dhe tentim për të falsifikuar historinë.

"Manovrat e tyre për të shndërruar Kosovën si "toke të shenjtë serbë" nuk qëndron, ngase serbet zyrtarisht ortodoksinë e kanë pranuar

nga shqiptarët, të cilët në masë të madhe ishin të përkatësisë fetare ortodokse, ngase pjesa me e madhe e tokave shqiptare pas vitit 1054, kur ndahet kisha në dy rite, në atë katolike – perëndimore dhe në atë ortodokse – lindor, i kanë takuar kishës lindor, ngase ishin në administrimin e Perandorisë Bizantine, perandori e cila si fe zyrtare e kishte ortodoksinë. Historia serbe është e ndërtuar mbi mite dhe gënjeshtër. Ata, si popull gjithnjë kanë qenë uzurpator dhe si të tillë sillen qysh nga shekulli VII, kur kanë ardhur në Ballkan si fise barbare", përfundon reagimi.



prestigjioz, zbarkimi i princit duhet të shoqërohet me shumë shkëlqim dhe pompozitet. Është shumë e domosdoshme gjithashtu, që anijet austriake dhe italiane të shoqërohen të paktën nga një luftanije angleze.

Pas një vizite 2-3 ditore në Krujë, Princi mund të zgjedhë lirshëm kryeqytetin e përkohshëm të Shqipërisë. Për këtë, Durrësi është një qytet që i rekomandohet në mënyrë të veçantë Lartësisë Tuaj për shkak të pozicionit gjeografik qendror të tij.

Për çdo rast, nëse Princi nuk dëshiron të bëhet lojë në duart e disa intrigantëve dhe kryehajdutëve, të cilët kanë mbushur me njerëzit e tyre radhët e policisë dhe xhandarmërisë, i duhet kërkuar Fuqive të Mëdha që të vendosin

në kryeqytetin e përkohshëm shqiptar një garnizon të trupave ndërkombëtare të Shkodrës. Mendoj që një batalion është i mjaftueshëm.

Pasi të gjitha këto të jenë vënë në vijë, Princi duhet të emërojë personalisht dhe individualisht disa ministra, për secilin departament. Për disa arsye, të cilat pata nderin t'i paraqes gojarisht dhe mendoj se janë të tepërta për t'i përsëritur këtu, për momentin është e pamundur të ngarkosh një njeri të vetëm për formimin e një kabinet homogjen. Emërimi i një kryeministri do të sillte shumë vështirësi.

Për momentin do të ishte e preferueshme të zgjidhen ministra pa lidhje direkte me njëri-tjetrin, të kryesuar nga shefi i shtetit, siç është rasti i ShBA-së.

Në rast se kjo ide nuk ju duket praktike, atëherë mund të përzgjidhet si kryeministër pa portofol një njeri i njohur si i paanshëm, siç është pronari i madh, Omer Pashë Vrioni. Për të thuhet se është i ndershëm, por paaftësia e tij është e njohur dhe këshillat e tij në përzgjedhjen e ministrave do të ishin pa vlerë.

Nuk do t'ju kujtoj argumentet e mia në favor të përzgjedhjes së një kryeqyteti tërësisht të ri. Kjo çështje do të diskutohet në thellësi kur të vijë momenti i duhur dhe do të jetë objekt i një kujtese speciale që do të kem nderin t'i parashtroj Lartësisë Tuaj.

**Berlin, 9 dhjetor 1913**  
Faik Konica

/Gazeta "Dita"/

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

'BUJQËSIA'

TEL: 045/82 82 82

## Hitzfeld: Xhaka ishte kapiteni madh kundër Francës



**CYRIH, 30 QERSHOR** - Ish-trajneri i Zvicrës, Ottmar Hitzfeld, e ka lartësuar Granit Xhakën për paraqitjen e mrekullueshme që ai e bëri në triumfin historik të Zvicrës kundër Francës në Kampionatin Evropian 2020, duke thënë se mesfushori shqiptar ishte një kapiten dhe lider i mirëfilltë në fushë. Xhaka e frymëzoi Zvicrën drejt arritjes së çerekfinaleve të parë në historinë e ekipit të vet kombëtar në një turne të madh në fitoren kundër Francës 5-4 me penallti të hënën në Bukuresht. Mesfushori i Arsenalit asistoi te goli i barazimit 3-3 në çastet e fundit të ndeshjes së 1/8 së finaleve, i shënuar nga Mario Gavranović, dhe ia mbajti një fjalim frymëzues ekipit helvetik para penalltive. Hitzfeldi, i cili ia dha

mundësinë Xhakës të debutojë për Zvicrën në moshën 18-vjeçare në një ndeshje kualifikuese për Euro kundër Anglisë në "Wembley" më 2011, ka thënë për mediat zvicerane se më së shumti mbeti i kënaqur me paraqitjen e mesfushorit nga Podujeva. "Zvicra bëri paraqitje të shkëlqyer kundër Francës. U udhëhoq shumë mirë nga Vladimir Petković. Në veçanti, jam i kënaqur me Granit Xhakën, Haris Seferovićin dhe Ricardo Rodriguezin, të cilët ishin në gjendje të ofronin çaste të veçanta. Unë iu besova këtyre tre lojtarëve kur ata ishin të rinj. Iu besova atyre, talentit dhe potencialit të tyre", ka deklaruar Hitzfeld. "Xhaka ishte kapiteni i madh kundër Francës, një lider i mirëfilltë i lojës", ka shtuar 72-

vjeçari. Ekipi zviceran u rikthye nga humnera pasi po humbiste me epërsi prej dy golave dhe e barazoi rezultatin në 3:3 në çastet e fundit të takimit të 1/8 së finaleve në Bukuresht, për ta mposhtur 5-4 në penallti kampionen e Botës, Francën. Zvicra e kishte humbur mundësinë për ta krijuar një epërsi prej 2-0 në fillim të pjesës së dytë, pasi Ricardo Rodriguez e humbi penalltinë dhe Xhaka, i cili u shpall lojtar i ndeshjes, i nxiti bashkëlojtarët të luftojnë për ta barazuar rezultatin dhe për ta çuar ndeshjen në penallti. Yann Sommer e mbrojti penalltinë e Kylian Mbappes dhe ia siguroi Zvicrës triumfin 5-4 në penallti. Zvicra do të përballet me Spanjën në çerekfinalen e së premtës.

## Mulleri: Rasti i humbur më dhemb në shpirt

**LONDËR, 30 QERSHOR** - Gjermania është eliminuar nga Kampionati Evropian pas humbjes nga Anglia (2-0). Pas golit të parë të Anglisë, mundësi të artë për të barazuar për Gjermaninë kishte Thomas Muller, por sulmuesi i Bayern Munchenit goditi pak centimetra larg portës. Pikërisht për atë rast, përmes një postimi në rrjetet sociale, Muller u kërkoi falje të gjithëve. "Ishte mundësia, një moment që e mban mend deri në fund, që nuk të lë të flesh gjumë. Për atë punon, stërvitësh dhe jeton si futbollist. Për atë moment, kur ke në dorë të këthesh situatën e ekipit tënd në një ndeshje të fortë me eliminim direkt, kur mund ta çosh popullin tënd në ekstazë. Ta kesh këtë mundësi dhe më pas ta lësh të shpëtojë, të dhembë në shpirt. Më dhemb për gjithë ekipin, shokët e mi të skuadrës dhe trajnerin tonë, që më dhanë menjëherë besimin për të qenë



edhe një herë aty. Por, mbi të gjitha, më dhemb për tifozët e Gjermanisë që qëndruan pranë nesh dhe na

mbështetën në këtë Kampionat Evropian, me gjithë situatën e vështirë", ka shkruar Mulleri.

"EURO 2020"

### Southgate: Fitorja ndaj Gjermanisë nuk vlen nëse nuk fitojmë ndaj Ukrainës

Trajneri i Anglisë, Gareth Southgate, kishte vetëm fjalë të mira për futbollistët e tij pas fitores së madhe që arritën ndaj Gjermanisë (2-0). "Luajtëm shumë mirë. Mendoj se e merituar fitoren, por unë u thashë menjëherë se nëse nuk fitojmë të shtunën, kjo e sotmja nuk vlen fare", ka thënë Southgate. "Donim të ushtronim shumë presion dhe menduam se nëse do të vendosnim lojtarë të shpejtë pas Harry Kane, do t'i shkaktonim probleme kundërshtarit. Mendoj se Saka dhe Sterling krijuan shumë probleme që nga fillimi i ndeshjes. Gjithashtu, mbrojtësit shumë mirë dhe portieri ynë ishte fantastik. Ishte një performancë e jashtëzakonshme", ka deklaruar Southgate.

### Pogba: Eliminimi na solli trishtim, kundërshtarit lumturi

Paul Pogba më në fund ka vendosur të deklarohet rreth eliminimit të Francës nga Kampionati Evropian. "Les Blues" u mposhtën në penallti (5-4) ndaj Zvicrës, derisa koha e rregullt dhe vazhdimet përfunduan 3-3. "Nganjëherë futbollit mund të jetë mizor... mizor dhe gjithashtu i bukur. Ndeshja na solli neve trishtim, por lumturi për kundërshtarët tanë. Kjo është bukuria e futbollit", ka thënë anëtari i Manchester Unitedit. "Natyrshet se të gjithë dëshironim që të kishim rezultat pozitiv. Falënderojmë tifozët nga e gjithë globi. Ishte e bukur t'ju shihnim, t'ju dëgjonim dhe të festonim me ju. Për në fund, dua ta uroj Zvicrën", ka thënë Pogba.

### Shevchenko: Nuk frikësohemi nga Anglia

Trajneri i Ukrainës, Andriy Shevchenko, ka thënë se ekipi i tij nuk do të frikësohet nga fitorja 2-0 të Anglisë ndaj Gjermanisë në "Wembley" në ndeshjen e tyre të 16-të fundit në "Euro 2020". Ukrainasit e siguruan një vend në çerekfinale me një fitore në kohën shtesë 2-1 ndaj Suedisë. "Anglia është një ekip i shkëlqyeshëm. Ka një stol me lojtarë të shkëlqyeshëm, një staf të jashtëzakonshëm, ne jemi plotësisht të vetëdijshëm se sa e vështirë do të jetë kjo lojë", ka thënë Shevchenko. "Unë i pashë të tria ndeshjet e saj në grupe, jo fitoren ndaj Gjermanisë, sepse u desh të përgatiteshim për ndeshjen tonë me Suedinë. Ajo është tepër e vështirë për të shënuar kundër, por forca e saj nuk duhet të na trembë. Duhet të na motivojë sepse gjithçka është e mundur në futboll si në jetë dhe ne do të luajmë zemrat tona për t'u dhënë tifozëve tanë edhe më shumë për të brohoritur", ka deklaruar Shevchenko. .

## Atleti Musa Hajdari merr ftesë për përfaqësim në Lojërat Olimpike

PRISHTINË, 30 QERSHOR - Musa Hajdari do ta përfaqësojë Kosovën në sportin e atletikës në Lojërat Olimpike "Tokio 2020". Atleti Hajdari për herë të dytë do të jetë pjesëmarrës në Lojërat Olimpike, pas debutimit në "Rio 2016".

Komiteti Olimpik i Kosovës dhe Federata e Atletikës e Kosovës kanë pranuar ftesën sipas vendit të rezervuar për univerzalitet. Musa garon në disiplinën vrapim 800 metra. "Sporti i atletikës dhe notit marrin ftesa të veçanta nga

Komiteti Olimpik Ndërkombëtar për pjesëmarrje në Lojërat Olimpike dhe, krahas një ftese të ndarë për atletikën, sporti i notit pritet të ketë dy ftesa, për të cilat KOK-u është në pritje të konfirmimit", thuhet në njoftimin e KOK-ut.

Komiteti Olimpik i Kosovës ka 11 sportistë, përfshirë dy të notit, të cilët do ta përfaqësojnë vendin në Lojërat Olimpike Tokio 2020. Lojërat Olimpike Tokio 2020 mbahen prej 23 korrik - 8 gusht 2021.



## Donita Lajqi: Nuk ka gjë më të madhe sesa ta paraqesësh vendin tënd

PRISHTINË, 30 QERSHOR - Pas përvojës me Kosovën U17, Donita Lajqi pret të tregohet e suksesshme me Përfaqësuesen U19 të Kosovës në hendboll. Donita bën karrierë në Norvegji dhe më 1 korrik do të jetë në dispozicion të Kosovës U19, që nis grumbullimin në Istog, Kosova U19 do të luajë në Evropianin e Divizionit B që prej 10 deri më 18 korrik mbahet në Shkup. Donita luan në pozitën e bekut të majtë dhe të qendrës. Karrierën e ka nisur në vitin 2010 në Lorenskog, ku i kaloi tetë vjet. Në vitin 2019 e kaloi një edicion te Ellingsrud, kurse prej marsit të vitit 2020 ishte tek Oppsal, ku vazhdon të jetë ende. Ajo momentin kryesor në karrierën në hendboll e cilëson zgjedhjen lojtarja më e mirë, derisa po paraqitej për Kosovën U17 ndaj Izraelit në vitin 2019. Ajo planifikon të luajë ende për Oppsalin. Tregon se është ndër klubet elite të Norvegjisë, kurse synim i Donita Lajqit është që një ditë të bëhet pjesë e ekipit të parë. Liga e Norvegjisë është e nivelit shumë të lartë. E pyetur se



a është e kënaqur që sërish do të luajë për Kosovën, Donita Lajqi është përgjigjur: "Po, natyrisht. Është një kënaqësi e veçantë dhe jam shumë e lumtur ta përfaqësoj Kosovën". Prej ndeshjeve në Shkup, Donita pret që "të gjitha vajzat ta japin maksimumin si kurrë më parë, sepse nuk ka diçka më të madhe në sport se ta prezantosh vendin tënd. Pres dhe besoj që kësaj

radhe do të fitojmë disa ndeshje në grup". Ftesën nga Përfaqësuesja e Kosovës e vlerëson si nder, kurse përsërit se është e lumtur që e prezanton vendin e saj. "Kam luajtur për Kosovën dy vjet më parë dhe ishte një përvojë e mirë dhe një ndjenjë e papërkrahshme. Falë përvojës nga dy vjet më parë, besoj se kësaj radhe do të dalim më mirë", ka shtuar Lajqi.

## Atlanta barazon serinë finale ndaj Millwaukees

ATLANTA, 30 QERSHOR - Atlanta Hawks vazhdon të surprizojë në fazën "play-off" të NBA-s. Skuadra nga Georgia triumfoi 110-88 ndaj Millwaukee Bucksit në sfidën e katërt të Serisë finale të Konferencës së Lindjes, duke barazuar rezultatin 2-2. Një sukses i madh për Hawksin pavarësisht prej mungesës së "yllit" të kësaj skuadre, Trae Young, për shkak të dëmtimit të kavigjës në takimin paraardhës, ndërsa Bucksit dridhet nga gjendja e Giannis Antetokounmpos, i cili lëndoi rëndë gjurin në mesin e periodes së tretë, duke qëndruar i shtrirë mbi parket mes dhimbjesh. Diagnoza e paraprake sugjeron zgjatje të ligamentit të gjurit, me Bucksin që mban frymën për të kuptuar nëse basketbollisti më i mirë i skuadrës do të mund të jetë i pranishëm në sfidat e ardhshme. Takimi tjetër tashmë zhvendoset në "Fiserv Forum" të Millwaukees, përplasje që premtan të jetë e nxehtë, pse jo



dhe vendimtare për fatin e serisë finale të Lindjes. Sa i përket ecurisë së kësaj përballjeje, pikërisht pas dëmtimit të Antetokounmpos Hawksit regjistruan një rezultat të pjesshëm 12-0, duke shkuar +20 pikë dhe "vlarë" përfundimisht ndeshjen, pasi Bucksit nuk kishte forcë për të reaguuar në periodes e fundit. Në mungesë të Trae Young, startues ishte Lou Williams, që rezultoi shënuesi

më i mirë për Hawksin me 21 pikë, ndërsa Bogdan Bogdanoviq shtoi 20 pikë të tjera. Giannis Antetokounmpo kishte luajtur një pjesë të parë të keqe me vetëm gjashtë pikë të shënuara, por kishte ndryshuar ritmin në minutat e para të periodes së tretë, duke realizuar menjëherë 8 pikë para dëmtimit. Për Bucksin numër dyshifror pikësh arritën vetëm Jrue Holiday (19) dhe Kris Middleton (15).

### SHKURT

#### Notarët Eda Zeqiri dhe Olt Kondirolli marrin ftesë për pjesëmarrje në Lojërat Olimpike

Eda Zeqiri dhe Olt Kondirolli do ta përfaqësojnë sportin e notit në Lojërat Olimpike "Tokio 2020". Të dy notarët janë ftuar nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar sipas vendeve të Univerzalitetit, vende këto që janë të rezervuara për sportet e notit dhe atletikës. Zeqiri do të garojë në disiplinën 400 metra stil i lirë, ndërsa Kondirolli në 100 metra stil i lirë. Në ftesën dërguar Komitetit Olimpik të Kosovës dhe Federatës së Notit të Kosovës nga Federata Ndërkombëtare e Notit (FINA), thuhet se të dy notarët janë renditur më së larti nga garuesit kosovarë në renditjen e pikëve të FINA-s.

#### Shala konfirmon largimin nga Flamurtari

Futbollisti Bashkim Shala nëpërmjet një postimi në profilin e vet në "Facebook" ka konfirmuar se është larguar nga skuadra e Flamurtarit të Prishtinës. "Ju informoj se që nga sot nuk do të jem më pjesë e Klubit FC Flamurtari. Dua t'i falënderoj bashkëlojtarët, trajnerët dhe kryesinë e klubit. Ju dëshiroj suksese në vazhdim", ka shkruar Shala.

#### Hamsiku përforcon Trabzonsporin

Pasi mbylli aventurën në Evropian me kombëtaren e Sllovakisë, Marek Hamsik zyrtarizoi transferimin në Turqi te skuadra e Trabzonsporit. Pas një sezoni në Suedi me fanellën e Goteborgut, 33-vjeçari vendosi ta vazhdojë karrierën pikërisht në Turqi. Lajmi u konfirmua nga vetë klubi në faqen zyrtare ku Hamsik shfaqet më i veshur me përkrenare gladiatorit dhe me fanellën me vija të ekipit. Sllovaku, i cili firmosi për dy vjet me klubin nga Superliga turke, do të përfitojë 1.5 milion euro në sezon plus bonuse.

#### Bastet favorizojnë Anglinë

Pas eliminimit të Gjermanisë dhe të Francës, Italia dhe Spanja bëhen favorite për të triumfuar në Kampionatin Evropian. Me fitoren e djeshme në "Wembely", anglezët janë kandidatët më të fortë për trofeun teksa suksesi i tyre kuotohet me koeficientin 3. Pas tyre Spanja, që kaloi me vështirësi Kroacinë, vlerësohet me koeficient 4. Podiumin e basteve e mbyll Italia. Për të besuarit e Roberto Mançinit koeficienti i suksesit është në vlerën 5, teksa menjëherë më pas vjen Lukaku me shokë. Një fitore e Belgjikës kuotohet me koeficientin 8. Pas suksesit ndaj Francës, Zvicra vlerësohet me 23, teksa 26 e ka koeficientin Republika Çeke e bomberit të turneut ende në garë, Patrik Schik.

#### Roma bën ofertë për Xhakën

Roma thuhet se ka bërë një lëvizje për mesfushorin e Arsenalit, Granit Xhaka, duke ofruar 12 milionë euro plus 3 milionë të tjera shtesë. "Sky Sport Italia" raporton se Giallorossi ka paraqitur një ofertë për të nënshkruar me 28-vjeçarin dhe se mesfushori dëshiron të bashkohet me Jose Mourinho në "Olimpico". Oferta nga La Lupa, sipas transmetuesit, ka një vlerë totale prej 15 milionë eurosh, me 12 milionë tani dhe 3 milionë të tjera në shtesa. Xhaka ka luajtur për Zvicrën në EURO 2020 këtë verë dhe dha sinjale se ai do të transferohet te Roma pas fitores kundër Francës. "Sky Sport Italia" foli me lojtarin e Arsenalit pas ndeshjes dhe ai u pyet nëse mund ta jepte intervistën në gjuhën italiane dhe Xhaka u përgjigj: "Italiane? Ende jo. Është gjithmonë interesante të mësosh një gjuhë të re. Kam mësuar anglisht, pse jo italisht? Le të shohim se çfarë ndodh. Sot unë jam një lojtar i Arsenalit, do të vendos për të ardhmen time pas Euros", ka shtuar Xhaka. Mourinho ka bërë me dije se ai dëshiron Xhakan dhe "Sky" raporton se lojtari është shumë afër që të bashkohet me portugezin në Romë.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria –Vlada - Government**

Ministria e Arsimit, Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit / Ministarstvo Obrazovanja, Nauke,  
Tehnologije i Inovacije / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Në bazë të nenit 67,68 të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrat e Publikë, nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 90/2010), Ligjit për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës nr. 04/L-032, Udhëzimin administrativ nr. 05/2015, Udhëzimin administrativ 05/2021, Udhëzimin administrativ nr. 02/2018 për Qendrat Burimore, Udhëzimin administrativ nr. 07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik dhe kërkesave të Qendrave Burimore, Departamenti i arsimit parauniversitar, shpall:

### KONKURS

Për vende të lira të punës në Qendrat Burimore/shkolla speciale

Nr.	Pozita	vendi i lirë/zëvendësimit	Nr. i pozitave
1.	Mësimdhënës/e të rrobaqepësisë në lëndët mësimore teorike në QB "Nënë Tereza" në Prizren.	vendi i lirë	1
2.	Mësimdhënës/e për lëndën teknologji - informatikë në QB "Nënë Tereza" në Prizren	vendi i lirë	1
3.	Mësues udhëtes në QB "Nënë Tereza" në Prizren	vendi i lirë	1
4.	Mësimdhënës/e e gjuhës shqipe në arsimin e mesëm të lartë në QB "Nënë Tereza" në Prizren		1
5.	Mësimdhënës/e e muzikës në QB "Nënë Tereza" në Prizren	vendi i lirë	1
6.	Mësimdhënës/e e gjuhës shqipe në arsimin e mesëm të ultë në QB "Nënë Tereza" në Prizren	vendi i lirë	1
7.	Mësues/e klase në QB "Nëna Terezë" në Mitrovicë	vendi i lirë	1
8.	Mësues/e klase në QB "Lef Nosi" në Prizren	vendi i lirë	1
9.	Mësues/e klase në sh.s. "Shpresa" në Shtime	vendi i lirë	1
10.	Eduktor/e në konvikt në QB "Xheladin Deda" në Pejë	vendi i lirë	1
11.	Asistent/e për fëmijët me nevoja të veçanta në QB "Nëna Terezë" në Mitrovicë	vendi i lirë	1
12.	Vozitës në QB "Nënë Tereza" në Prizren	vendi i lirë	1

#### I. Punët dhe detyrat krvesore të mësimdhënësit/es së rrobaqepësisë në lëndët mësimore teorike

- I realizon qëllimet dhe detyrat e arsimit dhe edukimit të mesëm të lartë;
- Planifikon dhe realizon planin vjetor dhe mujor të punës arsimore dhe edukative;
- Përdor metoda dhe teknika bashkëkohore të mësimdhënies duke marrë parasysh nevojat individuale të nxënësve;
- Përdorë shkathësi specifike për mësimdhënie në gjuhën e shenjave për nxënës me dëmtime në dëgjim.

#### 1. Përgatitja shkollore e mësimdhënësit të rrobaqepësisë në lëndët mësimore teorike:

- Msc. i tekstilit;
- Inxh. i dip. i tekstilit.

#### II. Punët dhe detyrat krvesore të mësimdhënësit/es për lëndën teknologji – informatikë

- I realizon qëllimet dhe detyrat e arsimit dhe edukimit të mesëm të lartë;
- Planifikon dhe realizon planin vjetor dhe mujor të punës arsimore dhe edukative;
- Përdor metoda dhe teknika bashkëkohore të mësimdhënies duke marrë parasysh nevojat individuale të nxënësve;
- Përdorë shkathësi specifike për mësimdhënie në gjuhën e shenjave për nxënës me dëmtime në dëgjim.

#### 2. Përgatitja shkollore e mësimdhënësit/es për lëndën teknologji – informatikë: Programi i mësimdhënies në Teknologji dhe TIK:

- Niveli master arsimor – Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

#### III. Punët dhe detyrat krvesore të mësuesit/es udhëtes/e:

- Identifikimi i nevojave për mbështetje në shkollë të rregullta;
- Mbatja e bazës së të dhënave për fëmijët e mbështetur në procesin gjithëpërfshirës;
- Planifikimi i orëve dhe forma e mbështetjes për një fëmijë;
- Hartimi i planeve vjetore, mujore dhe javore të punës;
- Takimi me mësues udhëtes të qendrës ku punon dhe të qendrave tjera.

#### 3. Përgatitja shkollore e mësuesit/es udhëtes/e:

- Niveli Master, arsimit gjithëpërfshirës;
- Fakulteti Filozofik- dega e pedagogjisë speciale;
- Departamenti i Pedagogjisë – edukimi për fëmijët me nevoja të veçanta;
- Fakulteti Filozofik- dega e pedagogjisë;
- Fakulteti i Edukimit- programi i arsimit fillor.

#### IV. Punët dhe detyrat krvesore të mësimdhënësit/es të muzikës:

- I realizon qëllimet dhe detyrat e arsimit dhe edukimit fillor;
- Planifikon dhe realizon planin vjetor, mujor të punës arsimore dhe edukative;
- Përdorë metoda dhe teknika bashkëkohore të mësimdhënies duke marrë parasysh nevojat individuale të nxënësve;
- Të ketë njohuri për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar;
- Të ketë njohuri për aplikimin e terapisë muzikore për fëmijët me dëmtime intelektuale.

#### 4. Përgatitja shkollore e mësimdhënësit/es të muzikës:

- Niveli master – Pedagogji e përgjithshme muzikore (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Baçelor - Pedagogji e përgjithshme muzikore (240 ECTS).

#### V. Punët dhe detyrat krvesore për mësimdhënës/e të gjuhës shqipe:

- I realizon qëllimet dhe detyrat e arsimit dhe edukimit fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë;
- Planifikon dhe realizon planin vjetor, mujor dhe javor të punës arsimore dhe edukative;
- Përdor metoda dhe teknika bashkëkohore të mësimdhënies duke marrë parasysh nevojat individuale të nxënësve;
- Përdor shkathësi specifike për mësimdhënie në gjuhën e shenjave për nxënës me dëmtime në dëgjim.

#### 5. Përgatitja shkollore për mësimdhënës të gjuhës shqipe:

- Niveli master – arsimor Fakulteti Edukimit (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

#### VI. Punët dhe detyrat krvesore të mësuesit/es të klasës:

- I realizon qëllimet dhe detyrat e arsimit dhe edukimit fillor;
- Planifikon dhe realizon planin vjetor, mujor të punës arsimore dhe edukative;
- Harton plane individuale për nxënës;
- Përdor metoda dhe teknika bashkëkohore të mësimdhënies duke marrë parasysh nevojat individuale të nxënësve.

#### 6. Përgatitja shkollore e mësuesit/es së klasës:

- Fakulteti i Filozofik – dega e pedagogjisë speciale;
- Departamenti i Pedagogjisë – edukimi për fëmijët me nevoja të veçanta;
- Fakulteti i Edukimit- programi i arsimit fillor;
- Fakulteti Filozofik – dega e pedagogjisë.

#### VII. Punët dhe detyrat krvesore të asistentit/es për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore:

- Ndhmon fëmijët/nxënësit në zhvillimin dhe promovimin e pavarësisë, orientim dhe mobilitet, transport, pozitën dhe uljen e nxënësit në klasë;
- Punon me mësimdhënësit dhe stafin tjetër për zbatimin e PIA-së, lëndë të individualizuara ose mësim në fusha të aktivitetëve;
- Përgatitë materiale mësimore si dhe menaxhon me pajisjet e nevojshme brenda dhe jashtë klasës;
- Mbikëqyrë dhe ndihmon fëmijët/nxënësit gjatë racioneve ushqimore, kujdeset për nevojat fizike dhe mjekësore të nxënësve dhe asiston në veshjen dhe pastërtinë e përgjithshme të tyre.

#### 7. Përgatitja shkollore e asistentit/es për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore :

- Niveli i 5 – të (post sekondar) i kualifikimit, asistent për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.

#### VIII. Punët dhe detyrat krvesore për edukator/e në konvikt:

- Bashkëpunojnë me arsimtarët që marrin pjesë në procesin mësimor;
- Bashkëpunojnë me mësimdhënësit e mësimin praktik dhe i dërgojnë nxënësit në mësimin praktik;
- Organizojnë dhe mbajnë këshilla me nxënësit rreth kryerjes së detyrave të shtëpisë;
- Kujdeset për nxënësit (në aspektin e edukimit, shëndetit, ushqimit, veshmbathjes dhe higjienës personale).

#### 8. Përgatitja shkollore për edukator/e në konvikt:

- Edukator/e – Fakulteti Filozofik – dega e pedagogjisë së përgjithshme.

#### IX. Përshkrim i vendit të punës vozitës:

- Është përgjegjës për automjetet e QB;
- Mirëmban automjetet e shkollës;
- Kujdeset për servisim të automjeteve;
- Është përgjegjës për regjistrim të automjeteve të Qendrës Burimore;
- Mban evidencë dhe bën raport javore, mujore dhe vjetore për shpenzimet dhe shfrytëzimin e automjeteve.

#### 9. Përgatitja shkollore

- Shkolla e mesme.

#### Kushtet e konkursit

Përzgjedhja e kandidatëve bëhet duke u bazuar në kriteret e Ligjeve që e rregullojnë fushën e arsimit: Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nr. 04/L-032, paragrafi 1.1 i nenit 12 të Udhëzimit administrativ nr. 05/2015, Normativin për mësimdhënësit e arsimit profesional, paragrafi 1, 14 dhe 16 i nenit 6, paragrafi 1 i nenit 7, paragrafi 2, 4 dhe 6 i nenit 8 dhe paragrafi 3 i nenit 9 të Udhëzimit administrativ 05/2021 për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm.

#### Dëshmi shtesë për fazën e paraseleksionimit

Certifikata të trajnimeve të akredituara nga MASHTI, gjegjësisht vetëm ato që konsiderohen relevante për vendin e punës sipas konkursit.  
Sqarim shtesë: – Informatat e dhëna në aplikacion konsiderohen të vlefshme vetëm nëse dëshmojnë me dokumente.

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet t'i kenë të nostrifikuara dokumentet në MASHTI. Në intervistë me shkrim ftohen kandidatët që i plotësojnë kriteret e konkursit. Kandidatët që aplikojnë duhet të jenë banor të Republikës së Kosovës.

Për të gjitha pozitat periudha provuese e punës është 1 (një) vit.

Pozitat për mësimdhënës përvoja e punës në procesin edukativ – arsimor 3 vite.

Për kandidatët që konkurrojnë në Qendrën Burimore "Nënë Tereza" në Prizren, përparësi kanë kandidatët që njohin gjuhën e shenjave.

Te pozita vozitës, kërkohet patentë shofer kategoria C (në mungesë të kategorisë C, mund të jetë edhe kategoria B).

#### Koeficient 4

#### Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik.

Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në Qendër Burimore).

Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë).

Diploma e kualifikimit (ose certifikatë) certifikata në vend të diplomës duhet të jetë e noterizuar.

Kandidatët, dokumentet duhet ti dorëzojnë në Qendrën Burimore/shkollën speciale përkatëse ku konkurrojnë. Aplikacionet e pakompletuara nuk shqyrtohen.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit- Ministarstvo Obrazovanja Nauka  
Tehnologije i Inovacije- Ministry of Education, Science and Technology

Na osnovu člana 67,68 Zakona o radu br. 06 / L-114 o javnim službenicima član 8 stav 1 i 2 Zakona o radu br. 03/L-212 (Službeni glasnik Republike Kosovo, br. 90/2010), Zakon o preduniverzitetskom obrazovanju u Republici Kosovo br. 04 / L-032, Administrativno uputstvo 05/2015 Administrativno uputstvo 05/2021 Administrativno uputstvo br. 02/2018, o Resursnim centrima, Administrativno uputstvo br. 07/2017 o regulisanju procedure konkurisanja u javnom sektoru i zahtevima Resursnih centara, Departament za preduniverzitetskom obrazovanju objavljuje;

### KONKURS

#### Za slobodna radna mesta u Resursnim centrima/specijalna škola

Br.	Položaj:	slobodno radno mesto/zamena	Br. pozicija
1.	Nastavnik/ca krojač/ca iz predmeta teorije u RC "Majka Tereza" u Prizren;	slobodno radno mesto	1
2	Nastavnik/ca iz predmet informativna - tehnologija u RC "Majka Tereza" u Prizren	slobodno radno mesto	1
3	Putujući nastavnik u RC "Majka Tereza" u Prizren	slobodno radno mesto	1
4	Nastavnik/ca albanskog jezika u više srednje obrazovanje u RC "Majka Tereza" u Prizren		1
5	Nastavnik/ca muzičkog u RC "Majka Tereza" u Prizren	slobodno radno mesto	1
6	Nastavnik/ca albanskog jezika u niže srednje obrazovanje u RC "Majka Tereza" u Prizren	slobodno radno mesto	1
7	Razredni učitelj u RC "Majka Tereza" u Mitrovica	slobodno radno mesto	1
8	Razredni učitelj u RC "Lef Nosi" u Prizren	slobodno radno mesto	1
9	Razredni učitelj/ca u s.š "Shpresa" u Štimlje	slobodno radno mesto	1
10	Vaspitač/ca u RC "Xheadin Deda" Peć	slobodno radno mesto	1
11	Asisten/ca za decu sa posebnim potrebama u RC "Majka Tereza" u Mitrovici	slobodno radno mesto	1
12	Jedna (1) sestra vaspitačica u dom u RC "Majka Tereza" u Prizren	slobodno radno mesto	1

#### I. Glavni zadaci i obaveze nastavnika/ce krojarstva iz teorijskog nastavnog predmeta

- Ispunjava ciljeve i obaveze više srednjeg obrazovanja za;
- Planira i realizuje godišnji i mesečni plan edukativno-obrazovnog rada;
- Koristi savremene nastavne metode i tehnike uzimajući u obzir individualne potrebe učenika;
- Koristite specifične veštine za nastavu znakovnog jezika za učenike sa oštećenim sluhom.

#### 1. Školska sprema nastavnika krojača/ce iz nastavnog predmeta teorije:

- Msc. tekstila;
- Dip. ing. tekstila.

#### II. Glavni radni zadaci i obaveze nastavnika /ce za predmet Informativa tehnologija

- Ispunjava ciljeve i obaveze više srednjeg obrazovanja za;
- Planira i realizuje godišnji i mesečni plan edukativno-obrazovnog rada;
- Koristi savremene nastavne metode i tehnike uzimajući u obzir individualne potrebe učenika;
- Koristite specifične veštine za nastavu znakovnog jezika za učenike sa oštećenim sluhom.

#### 2. Školska sprema nastavnika/ce za predmet tehnologija - informatika Nastavni program iz Tehnologije i TIK;

- Nivo obrazovni master - Edukativni fakultet (300ECTS);
- Četvorogodišnji sistem
- Bachelor (četverogodišnji 240 ECTS).

#### III. Glavni zadaci i obaveze putujućeg nastavnika/ce

- Indentifikacija potrebe za podršku u redovnim školama;
- Održavanje baze podataka za decu podržana sveobuhvatnim procesom;
- Planiranje časova i oblik podrške za određeno dete;
- Izrada godišnjih, mesečnih i nedeljnih planova rada;
- Sastanak sa putujućim nastavnikom centra u kojem radi i drugih centara.

#### 3. Školska sprema putujućeg nastavnika/ce

- Master nivo, inkluzivno obrazovanje;
- Filozofski fakultet - smer specijalna pedagogija;
- Departament pedagogije- Vaspitanje za decu sa posebnim potrebama;
- Filozofski fakultet - smer pedagogija;
- Edukativni fakultet - program osnovno obrazovanje.

#### IV. Glavni zadaci i obaveze nastavnika/ce muzičkog

- Ispunjava ciljeve i obaveze osnovnog obrazovanja i vaspitanja;
- Planira i realizuje godišnji i mesečni plan edukativno-obrazovnog rada;
- Koristi savremene nastavne metode i tehnike uzimajući u obzir individualne potrebe učenika;
- Da ima znanje o obrazovanju dece sa ograničenim sposobnostima;
- Da poznaje primenu muzikoterapije za decu sa intelektualnim oštećenjima.

#### 4. Školska sprema nastavnika/ce iz muzičkog:

- Nivo master- Opšta muzička pedagogija (300 ECTS);
- Četvorogodišnji sistem;
- Bachelor - Opšta muzička pedagogija (240 ECTS).

#### V. Glavni zadaci i obaveze nastavnika/albanskog jezika

- Ispunjava ciljeve i obaveze osnovnog obrazovanja i vaspitanja, niže srednjeg i više srednjeg obrazovanja;
- Planira i realizuje godišnji i mesečni edukativni i obrazovni plan rada;
- Koristi savremene nastavne metode i tehnike uzimajući u obzir individualne potrebe učenika;
- Koristite specifične veštine za nastavu znakovnog jezika za učenike sa oštećenim sluhom.

#### 5. Školska sprema za nastavnika albanskog jezika

- Master – obrazovni nivo - Edukativni fakultet (300ECTS);
- Četvorogodišnji sistem;
- Bachelor (četverogodišnji 240 ECTS).

#### VI. Glavni zadaci i obaveze razrednog/ne učitelja/ce:

- Ispunjava ciljeve i obaveze osnovnog obrazovanja i vaspitanja;
- Planira i realizuje godišnji i mesečni plan edukativno-obrazovnog rada;
- Sastavlja individualne planove za učenike;
- Koristi savremene nastavne metode i tehnike uzimajući u obzir individualne potrebe učenika.

#### 6. Školska sprema razrednog/e učitelja/ce

- Filozofski fakultet- smer specijalna pedagogija;
- Departament pedagogije- Vaspitanje za decu sa posebnim potrebama;
- Edukativni fakultet - program osnovno obrazovanje;
- Filozofski fakultet - smer pedagogija.

#### VII. Glavni zadaci i obaveze asistenta/ce za decu sa posebnim obrazovnim potrebama:

- Pomaže deci / učenicima u razvoj i promociji nezavisnosti, orijentacije i mobilnosti, transporta, položaja i sedenje učenika u učionici;
- Radi sa nastavnicima i ostalim osobljem na implementaciji IPO-a, individualiziranim predmetima ili nastava u oblastima aktivnosti;
- Priprema nastavne materijale kao i menadžira sa potrebnom opremom unutar i izvan učionice;
- Nadgleda i pomaže deci / učenicima tokom obroka hrane, brine o fizičkim i medicinskim potrebama učenika i pomaže u njihovoj celokupnoj higijeni.

#### 7. Školska sprema asistenta/ce za decu sa posebnim potrebama obrazovanja:

- Nivo i 5- ti (post sekundarno), kvalifikacija , asistent za decu / učenika sa posebnim obrazovnim potrebama .

#### VIII. Glavni zadaci i obaveze vaspitača/će za u dom

- Saraduje sa nastavnicima koji učestvuju u nastavnom procesu;
- Saraduje sa nastavnicima praktične nastave i šalju učenike na praktičnu nastavu;
- Organizuje i održava savetovanje sa učenicima o obavljanju domaćih zadataka;
- Stara se za učenike (u pogledu vaspitanja, zdravlja, ishrane, odeće i lične higijene).

#### 8. Školska za vaspitača/ce u dom

- Vaspitač/ca - Filozofski fakultet, - smer opšta pedagogija;

#### IX. Opis radnog mesta šofera:

- Odgovoran je za održavanje vozila u RC;
- Održava školska vozila;
- Stara se o servisiranju vozila;
- Odgovorna je za registraciju vozila u Resosrom centru;
- Vodi evidenciju i nedeljne, mesečne i godišnje izveštaje o potrošnji i upotrebi vozila.

#### 9. Školska sprema

- Srednja škola

#### Uslovi konkursa

Izbor kandidata se vrši na osnovu kriterijume Zakona koji regulišu oblast obrazovanja: Zakon o preduniverzitetskom obrazovanju u Republici Kosovo, br. 04 / L-032, stav 1.1 člana 12 Administrativnog uputstva br. 05/2015, Normativ za nastavnike profesionalnog obrazovanja, stav 1, 14 i 16 člana 6, stav 1 člana 7, stav 2, 4 i 6 člana 8 i stav 3 i člana 9 Administrativnog uputstva 05/2021 o Normativu o profesionalnom kadru opšteg obrazovanja.

#### Dodatni dokaz za predkvalifikacionu fazu:

Certifikat o treninzima akreditovanih od strane MONTI-a, odnosno samo oni koje se smatraju relevantnim za radno mesto prema konkursu.

Dodatno obrazloženje: -Informacije prikazane u aplikaciji smatraju se validnim samo u koliko budu potkrepljeni dokazom

Osobe koje su diplomirale van Kosova moraju dostaviti da je izvršena nsotifikacija dokumenta od strane MONTI-a.

Na pismenom intervju će biti pozvani samo kandidati koji ispunjavaju kriterije konkursa. Kandidati koji apliciraju moraju biti stanovnici Republike Kosovo.

Za sve pozicije probni radni staž je 1 (jedna) godina.

Pozicija za nastavnike radno iskustvo u edukativno-obrazovnom sistemu 3 godine.

Za kandidate koji konkurišu u Resursnom centru Majke Tereze u Prizrenu prednost imaju kandidati koji poznaju znakovni jezik.

Za položaj šofera zahteva se da poseduje vozačku dozvolu C kategorije ( u nedostatku kategorije C +, može i B kategorija).

#### Koeficijent 4

#### Rok i način apliciranja


Konkurs ostaje otvoren 15 dana od objave konkursa u medijima javnog informisanja.

Popunjena formulara za aplikaciju (može se dobiti u Resursne Centre).

Lični dokument (lična karta ili pasoš).

Diploma kvalifikacije (ili sertifikat) sertifikat umesto diplome mora biti noterizovan;

Kandidati, dokumenta trebaju predati u relevantni Resursni centar / Specijalnu školu u kojoj konkurišu. Ne kompletirane aplikacije neće se uzeti na razmatranje.



# Lume's Details

## Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

### NJOFTIM


Njoftojmë të gjithë klientët se "MELLON SOLUTIONS DOOEL KOSOVO BRANCH" ka marrë vendim të shuaj biznesin me nr. Unik: 810829591 si dhe me nr. të TVSH-së, 330240850 ku ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

### OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "MELLON SOLUTIONS DOOEL KOSOVO BRANCH" donelo odluku o prestani rada sa nr. Unik: 810829591, nr. TVSH 330240850 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

### ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "MELLON SOLUTIONS DOOEL KOSOVO BRANCH" has come to the decision to quit its nr. Unik: 810829591, nr. TVSH 330240850 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Lejla Mavriqi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Ekonomike "Hoxhë Kadri Prishtinë" Prishtinë.
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoh një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales




**MEKA**  
HALAL FOOD

## PASHTETË PULE

gluten  
free



100% mishi pule



cilësi e garantuar

pa konservues